



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.09.2016, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i shqyrtimit të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili, Vexhi Mucmata, Arben Ristani, Aldo Bumci, Keltis Kruja.

Mungojnë:

Spartak Braho, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Jon Smibert – Ekspert i Nivelit të Lartë

Korajlka Bumci - Eksperte e Nivelit të Lartë

Arben Rakipi - Ekspert i Nivelit të Lartë

Artan Hoxha - Ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Rihapim mbledhjen e komisionit për vazhdimin e shqyrtimit të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Keni pasur mundësinë të njiheni me amendamentet e propozuara nga kolegët e opozitës, me reflektimet rreth tyre nga grupi i ekspertëve. Keni, gjithashtu, të formalizuar në një tabelë të gjithë reflektimin që ekspertët kanë bërë mbi bazën e propozimeve që janë parashtruar nga kolegët e opozitës dhe kolegët e tjerë, përfshirë propozimet e zotit Vasili, të zonjës Hysi, të zotit Manja, më falni!

Do të ecim me këtë dokument, duke mbajtur në konsideratë edhe ndryshimet e reflektuara, për të mos i cituar atje ku nuk është e nevojshme për ekonomi kohe.

Do të bëjmë edhe një mirëkuptim: sa herë që djali që është aty në të djathtë, që ka barrën e përkthimit (një punë të vështirë) të ngrejë dorën, ta respektojmë, për efekt që edhe atij t’ia lehtësojmë detyrën e vështirë që ka marrë përsipër.

Në rregull.

Atëherë, mund të fillojmë.

Zoti Manja, nuk ka ndonjë gjë në hyrje, pra besoj se mund të fillojmë direkt.

(Deputeti Manja flet pa mikrofon.)

Në rregull.

Fillojmë me nenin 1 “Objekti i ligjit”.

Ka ndonjë gjë?

Ulsi Manja – Në pikën 4 të nenit 1 lidhur me objektin, propozoj një riformulim, duke përcaktuar edhe kritere shtesë jo vetëm për emërimin, por edhe për transferimin dhe ngritjen në detyrë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Ulsi Manja – Në pikën 6, pas fjalëve “të Byrosë Kombëtare të Hetimit” të shtohet: “, si dhe kontrollit të të dhënave financiare dhe të telekomunikacioneve të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...pasi këtë term e përdor edhe Kushtetuta te pjesa e kushteve shtesë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. Jemi dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Miratohet. Faleminderit!

Neni 2 “Qëllimi i ligjit” ka ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për nenin 2?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, amendamenti...

Oerd Bylykbashi – Amendamenti 1, në fakt, është në lidhje me nenin 2.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po. Keni diçka për amendamentin 2?

Vasilika Hysi – Lidhur me amendamentin 1, që ndryshon nenin 2, propozim i ardhur nga opozita, mund të ketë një riformulim, në kuptimin që qëllimi i këtij ligji nuk është krijimi i Prokurorisë së Posaçme apo i Njësisë së Pavarur Hetimore, sepse ato janë krijuar me Kushtetutë, pra janë tashmë të rregulluara në Kushtetutë, në nenin 148, por qëllimi i ligjit është që, nëpërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Njësisë së Pavarur Hetimore, si organe të specializuara, të kemi një ndjekje penale efektive, të pavarur, për çështjet e korrupsionit dhe krimet të organizuar, si dhe për krimet e kryera nga një kategori e caktuar zyrtarësh dhe ish-zyrtarësh; hetim i pavarur nga çdo ndikim i brendshëm dhe i jashtëm i paligjshëm. Pra, mund të pranohet pjesërisht rekomandimi, amendimi i bërë nga opozita, duke formuluar, duke nxjerrë qartë qëllimin që ka veprimtaria e këtyre funksioneve.

Nga ana tjetër, ky pranim i pjesshëm bëhet edhe për një arsye të dytë: duhet bërë dallimi i objektit të ligjit, sepse në nenin 1 thuhet: “Përcaktohen rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Prokurorisë së Posaçme dhe të Njësisë së Pavarur”. Kështu, nga neni 2 do të dalë qëllimi se çfarë synojnë këto institucione të posaçme. Prandaj...

Fatmir Xhafaj – Biem dakord...?

Vasilika Hysi – ...të bëhet një riformulim.

Fatmir Xhafaj – Është *okej* për ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Reflektim të jetë.

Vasilika Hysi – Zoti Bylykbashi, riformulimi që i keni bërë ju jep përsëritjen...

Fatmir Xhafaj – Po, po, po!

Vasilika Hysi – Prandaj duam që të shmangen përsëritjet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Vazhdojmë me ndryshimin e nenit 2.

Neni 3 “Përkufizimet”.

Ulsi Manja – Jemi dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka asnjë ndryshim, vetëm se te pika 3 e nenit 3...

Fatmir Xhafaj – Keni vendosur...

Ulsi Manja – Nga 60 ditë, i cili propozohet: “personi që banon më shumë se 120 ditë në vit në të njëjtin vendbanim”, pra nga 60 në 120 ditë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, miratohet. Faleminderit!

Neni 4 “Prokuroria e Posaçme”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka gjë.

Dakord? Miratohet, siç është.

Faleminderit!

Neni 5 “Byroja Kombëtare e Hetimit”.

Ulsi Manja – Shprehemi dakord.

Oerd Bylykbashi – Për sa i përket terminologjisë, së pari, është terminologji kushtetuese: “Njësia e Posaçme Hetimore”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë, më falni!

Ndërkohë, siç u parashtrua, ky është një nga nenet... Amendamenti që bëjmë ne lidhet me çështjen e parë që shtruan në lidhje me pavarësinë e kësaj që ne quajmë “Byro Kombëtare Hetimi” apo “Njësi e Posaçme Hetimore”. Kështu që lidhet edhe me ndryshimet e tjera që kemi bërë, ndoshta duhet parë më pas, por...

Qëllimi është për të garantuar maksimalisht pavarësinë e...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vexhi Muçmataj – Nenin 5.

Oerd Bylykbashi – ...Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, faleminderit!

Po, zoti Muçmataj.

Vexhi Muçmataj – Për nenin 5 mendoj, duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet që kanë bërë kolegët e opozitës, të bëjmë një reformulim tjetër, duke harmonizuar nenin 5 me sugjerimet e kolegëve të opozitës.

Mendoj se edhe titulli duhet të ndryshojë dhe të jetë: “Funksionet e Byrosë Kombëtare të Hetimit”, pastaj formulimi mendoj të jetë: “1. Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar hetimi e Policisë Gjyqësore, e cila ka në përbërjen e saj edhe shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji.

2. Byroja Kombëtare e Hetimit, në hetimin e veprave penale, në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme, ushtron funksionet e saj sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale.

3. Hetuesit ose oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të shërbimeve të Policisë Gjyqësore drejtohen dhe kontrollohen në veprimtarinë hetimore procedurale vetëm nga prokurorët e posaçëm”.

Fatmir Xhafaj – Pra, ju sugjeroni një reformulim...

Vexhi Muçmataj – Të ri.

Fatmir Xhafaj – ...me tre paragrafë, siç e kuptoj unë, thjesht për reflektime teknike, pa e ndryshuar thelbin e kësaj?

Vexhi Muçmataj – Po, pa e ndryshuar thelbin.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Siç është, për ta ndarë në tre paragrafë si riformulim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Oerd Bylykbashi – Kemi një amendament për këtë...

Fatmir Xhafaj – Që nuk gjen mbështetje.

Oerd Bylykbashi – Që nuk gjen mbështetje, dakord, por e konsiderojmë si çështje të rëndësishme në lidhje me pavarësinë e këtij organi. Ne gjykojmë që kështu siç është ky nen...

Fatmir Xhafaj – “Veprojnë vetëm nën drejtimin e prokurorit special të Prokurorisë së Posaçme”. Më shumë se kaq, çfarë? Këtë ka Kushtetuta, këtë theksoi edhe zoti Muçmataj, e ndau më vete, si paragraf, që pavarësia të jetë më e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vexhi Muçmataj – E harmonizova unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po, jam i bindur që...

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po, po.

Vexhi Muçmataj – Pika e parë, Oerd, është: “1. Byroja Kombëtare e Hetimit është strukturë e specializuar hetimi e Policisë Gjyqësore, që ka në përbërjen e saj edhe shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas këtij ligji.

2. Byroja Kombëtare e Hetimit, në hetimin e veprave penale, në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme, ushtron funksionet e saj sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale”.

Fatmir Xhafaj – Sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale, pra në këtë ligj dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Vexhi Muçmataj – Po, sepse Kodi i Procedurës Penale (nga neni 30, 31, 32 e në vijim) parashikon funksionet e Policisë Gjyqësore dhe të shërbimeve të Policisë Gjyqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Formulimi që është, sigurisht që ka ndërprerje edhe në pika të tjera...

Vexhi Muçmataj – Pika 3 për pavarësinë të bëhet: “3. Hetuesit ose oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të shërbimeve të Policisë Gjyqësore drejtohen dhe kontrollohen në veprimtarinë hetimore procedurale vetëm nga prokurorët e posaçëm”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Koncepti që keni ju, pra ky që është në ligj, është i një strukture, e cila është e shtrirë edhe në organe të tjera. Ndërkohë, ajo që kërkojmë ne është që rekrutimi, organizimi dhe drejtimi i punës...

Vexhi Muçmataj – Do të dalim më mbrapa...

Oerd Bylykbashi – ...është plotësisht dhe vetëm brenda kësaj strukture nuk është shtrirë.

Vexhi Muçmataj – Do të vijmë më vonë.

Oerd Bylykbashi – Por kështu siç është, sigurisht te neni tjetër, ju vazhdoni me të njëjtin koncept.

Fatmir Xhafaj – E qartë, por, mirë, dakord, në koncept mund të ndryshojmë tani, nuk kemi çfarë të bëjmë.

Oerd Bylykbashi – Nuk është çështja... Pra, jemi në themel. Domethënë, praktikisht më pas ju e detajoni dhe pranoni që këto struktura janë jashtë Byrosë Kombëtare, ndërkohë që ajo çka kërkojmë ne është që duhet të jenë të gjitha plotësisht dhe brenda Byrosë Kombëtare të Hetimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Mbylleni pak mikrofonin, zoti Muçmataj!

Petrit Vasili – Nuk ka problem, se dëgjohe!

Ndoshta-ndoshta mund të sugjerohej kjo gjë, që në pikën e parë...

Unë jam dakord me të gjitha parashtrimet e zotit Muçmataj për të davaritur çdo lloj keqkuptimi, por mund të thoshim: “Byroja Kombëtare e Hetimit është në varësi administrative dhe funksionale të Prokurorisë së Posaçme”. Varësia administrative dhe funksionale shuan atë...

Fatmir Xhafaj – Është në Kushtetutë.

Petrit Vasili – ...atë merak që ne kemi.

Fatmir Xhafaj – Vini formulimin e Kushtetutës dhe jeni të saktë.

Në rregull. Kemi ndonjë gjë tjetër për këtë?

Oerd Bylykbashi – Unë besoj që nuk e zgjidh problemin...

Fatmir Xhafaj – Po mirë, zoti Bylykbashi mendon se kjo nuk e zgjidh problemin. A keni ndonjë gjë tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Kryetari i komisionit flet anglisht.)

Në rregull, biem dakord me atë. Gjithsesi, saktësojeni në riformulim kur ta zbardhin, sepse...

(Deputeti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Dakord.

Po, zoti Bylykbashi, zoti...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë t'i them unë tani? Ju lutem tani!

Unë e kuptoj shumë mirë që është ajo që ka thënë, por ata e duan siç e thonë ata, por jo kështu.

Oerd Bylykbashi – Të lutem, mos bëj komente!

Fatmir Xhafaj – Po, dakord.

Atëherë, zoti Bylykbashi është kundër.

Oerd Bylykbashi – Unë gjykoj se lidhur me nenet e tjera nuk e zgjidh problemin...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – ...sepse te nenet e tjera, me sa po shoh, është e pazgjidhur çështja që kemi ngritur ne.

Fatmir Xhafaj – Ai bëri një përpjekje që të merrte në konsideratë edhe propozimin tuaj dhe propozimi i ekspertëve është shumë i qartë.

Thjesht për efekt të teknikës për t'i detajuar e ndau me pika; asgjë tjetër dhe bashkoi edhe këtë tuajin. Ju nuk bini dakord. Votoni kundër.

Oerd Bylykbashi – Dakord, mor zotëri, mund ta ndash me pika, por në substancë mbetet, sepse është i lidhur me nene të tjera...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – ...dhe ju keni idenë e një policie gjyqësore që ta...

Fatmir Xhafaj – E qartë.

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk do ta kenë pjesë të brendshme të tyre, vetëm e tyre, por do të merret edhe nga institucionet e tjera.

Fatmir Xhafaj – Pra...

Oerd Bylykbashi – E ke më pas.

Fatmir Xhafaj – ...ju jeni kundër për këtë gjë, gjithsesi, miratohet.

Neni 6 “Kushtet e sigurisë para caktimit ose emërimit në detyrë”.

Ulsi Manja – Shprehemi dakord për nenin 6, siç është në variantin e datës 08.09.2016.

Fatmir Xhafaj – Që e kemi këtu.

Ulsi Manja – Sipas asaj që ka drafti.

Fatmir Xhafaj – Që e kanë sjellë ekspertët.

Ulsi Manja – Po.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Keni amendament për nenin 6?

Vasilika Hysi – Jo, jo, më falni!

(Diskutime në sallë.)

Oerd Bylykbashi – Këtu ka një propozim nga ekspertët, i cili përpiqet të reflektojë amendamentin që kemi bërë ne...

Fatmir Xhafaj – Po.

Oerd Bylykbashi – ...ku ky kontroll nuk do të kryhet më nga këto institucione, si ILDKP-ja, pra nuk do të kryhet nga këto institucione-që janë nën kontrollin e ekzekutivit, por do të kryhet nëpërmjet një komisioni *ad hoc*, me ato formulimet transitorë për sa u përket fazave fillestare. Ekspertët kanë bërë një propozim që e trajton këtë shqetësim tonin, të ngritur në amendament...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...dhe do të mbështesim këtë opsion.

Vasilika Hysi – A mund të bëj një sqarim?

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Në fakt, ne lexuam me kujdes disa riformulime të bëra në nenin 6, bazuar në propozimin e kolegëve të opozitës. Një pjesë e madhe e riformulimeve të bëra bie ndesh me Kushtetutën, por, në radhë të parë, me aneksin e Kushtetutës, nenin “d”, i cili e sqaron qartë se cilat janë organet që merren me kontrollin e pastërtisë së figurës, të pasurisë...

Lidhur me propozimin që ju keni bërë për të krijuar një komision *ad hoc* për rekrutimin e kandidatëve, kjo gjë është e pamundur dhe absurde në logjikë. Pse? Ju thoni: “Para se të ngrihen këto institucione, kandidatëve për gjyqtar/prokuror duhet t’u verifikohet pasuria dhe figura”. Po!

Kur shtrohet çështja se kush do ta bëjë verifikimin e kandidatëve për prokurorë dhe gjyqtarë, ju thoni: “duhet ta bëjë një komision i posaçëm”.

Kur shkojmë te pika “Nga kush do të përbëhet komisioni i posaçëm?”, ju thoni: “Nga dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, nga një gjyqtar i Gjykatës së Posaçme dhe një hetues i Njësisë së Posaçme Hetimore”. Pra, ju flisni që njerëzit që do të punojnë në këto institucione do të zgjidhen nga një komision i posaçëm, i përbërë nga njerëz të institucioneve që nuk janë krijuar ende?!

Tani që flasim institucionet nuk ekzistojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mbaroj!

Institucionet nuk ekzistojnë.

Çfarë keni bërë ju më pas? Keni propozuar një rregull përjashtimor për vitet e para. Po të lexoni rregullin përjashtimor, që bëni te pika 7 e këtij neni, ju thoni: “Përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në paragrafin 3”. Çfarë thotë paragrafi 3? Ky paragraf nuk flet se kush i ngre këto institucione, por thotë se ku e dorëzon pyetësoin e sigurisë kandidati. Kjo ishte e para, referenca.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Problemi i dytë është që Kushtetuta e ka përcaktuar qartë se cilat janë institucionet që do të bëjnë vetingun. Pra, riformulimi që sillni ju, më falni, jo vetëm që shkel Kushtetutën, por cenon edhe ligjin “Për vetingun”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për ngritjen e institucioneve të para, kush do të bëjë vlerësimin e pastërtisë së figurës, të pasurisë së personave...

Oerd Bylykbashi – ...proces i përhershëm.

Vasilika Hysi – Por ne nuk i kemi ngritur ende institucionet, po jua them edhe një herë...

(Deputeti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Më falni tani!

Ne po flasim që t'i ngremë institucionet, sepse nuk i kemi ngritur ende.

Nuk mund të kontrollohen këto subjekte në momentin kur këto institucione nuk i ke ngritur me një komision *ad hoc*. Kjo ishte e para.

Oerd Bylykbashi – Përjashtimi është që komisioni i përkohshëm i kualifikimit do ta bëjë këtë punë për katër vjetët e para. E ke të ngritur këtë.

Po nuk e ngrite këtë që në fillim, ti nuk bën dot vetingun.

Vasilika Hysi – Ne po flasim në nenin 6, për kushtet e atyre që do të fillojnë punë në këto institucione.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Neni 7...

Tani, këto janë të gjitha kushtet.

Pika 7 e nenit 6, që ju thoni se këtë do ta bëjë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, po t'i kthehem neni 179/b aty kemi rregullat dhe institucionet që do ta bëjnë këtë vlerësim: vlerësimin e pasurisë...

Oerd Bylykbashi – E ke për vetingun.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Më falni tani, të mbaroj, mor!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më dëgjo!

Kontrollin e pasurisë nuk mund ta bëjë një komision i posaçëm, i përbërë nga prokurorë të posaçëm. Në Kushtetutë (te neni i verifikimit të pasurisë) janë përcaktuar dhe thuhet: “Të gjithë këta persona brenda 30 ditëve bëjnë deklaratën” dhe ka institucione që

bëjnë raportin dhe opinionin, të cilët ia paraqesin komisionit të kualifikimit. Pra, nuk mund të jetë prokurori për prokurorin, këtë po ju them.

Në pjesën e parë të mbledhjes, përpara se ta ndërprisnit, ju gjithë kohës thatë: “duhet të shmangim krijimin e një vëllazërie”. Tani, me këtë sugjerim që ju bëni, e keni bërë vëllazërinë më të ngushtë, keni vënë disa vëllezër edhe më të ngushtë, që prokurorët të kontrollojnë prokurorët.

(Deputeti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Prandaj, duhet të jemi në përputhje me Kushtetutën, me aneksin e saj dhe me ligjin “Për vetingun”.

Gjithashtu, zoti kryetar...

Fatmir Xhafaj – Qartë, qartë!

Vasilika Hysi – Në pikën 6 kanë propozuar...

Fatmir Xhafaj – Pse hyni në shumë...? U kuptuan.

Vasilika Hysi – Meqenëse...

Në pikën 6 ju thoni: “Kandidati dorëzon deklaratën e pasurisë dhe të sigurisë të një komisioni i posaçëm”. Jo, e ka rregulluar aneksi i Kushtetutës se ku dorëzohen këto deklarata dhe se kush i verifikon ato.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Zoti Manja, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi – Unë nuk e di, domethënë, rrugët kryqëzohen diku dhe ikin pastaj shtrembër, Vasilikë! Nuk e kuptoj logjikën që po përdorni.

Për sa i përket vetingut, edhe në Kushtetutë është parashikuar një proces i përkohshëm me një qëllim të caktuar. Këtu nuk jemi përpara vetingut, nuk quhet veting ky procesi këtu. Ky është një proces që do të vazhdojë për sa kohë do të funksionojë kjo strukturë: Gjithmonë? Gjithmonë!, 100 vitet e ardhshme? 100 vitet e ardhshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, ky nuk është vetingu i asaj çfarë parashikon Kushtetuta.

Fatmir Xhafaj – Kush e emëron me 100 vjet prokurorin e Prokurorisë Speciale?

Oerd Bylykbashi – Ta mbaroj, zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj – Organ i emërtimit është Këshilli i Prokurorisë.

Oerd Bylykbashi – Fakti që fjala “veting” ekziston, nuk lidhet domosdoshmërisht vetëm me aneksin. Ne veting mund të bëjmë për shumë gjëra. Sot e kësaj dite bëhet, e bëjnë edhe shërbime të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk ka lidhje me germën “b” të nenit 179. Ky është funksionimi. Ne po bëjmë një ligj për funksionimin e këtyre strukturave dhe sigurisht ato do të kenë filtrat e kontrollit të tyre, pra do të jenë për të gjithë kohën që do të ekzistojë ky ligj, kurse strukturat e vetingut janë me periudhë të përcaktuar në kohë. Mbyllet ai proces, ikin ato, shuhen.

Fatmir Xhafaj – E qartë.

Oerd Bylykbashi – Ajo që po themi, për të shfrytëzuar një institucion që ngrihet menjëherë që në fillim, se e kaluam ligjin, është se komisionet e përkohshme të kualifikimit do ta luajnë këtë rol në fazën e parë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Dhe këtu nuk ka asnjëlloj konflikti me Kushtetutën.

Tani, fakti se diku u përmend ILDKP-ja vetëm për vetingun, nuk do të thotë që këtë mund ta replikosh kudo.

Në qoftë se ju na thoni që me ILDKP-në dhe DSIK-në, institucione shtetërore, na forcohet pavarësia e institucioneve, duhet ta mendojmë edhe një herë çfarë dimë ne për pavarësinë.

Mos u çudit, Pandi!

Ndërkohë, ajo që ne po kërkojmë është: sa kohë rrëzohet, nuk pranohet propozimi ynë, që kjo të bëhet nga jashtë strukturës, por nga një institucion i pavarur, siç është Prokuroria e Përgjithshme, meqenëse kjo nuk pranohet, por është e pavarur nga ana tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...ne absolutisht nuk e çojmë nëpër mend idenë që një organ ekzekutiv, edhe i pakontrolluar, ta bëjë këtë kontroll mbi prokurorët e posaçëm, pasi është cenim i drejtpërdrejtë i pavarësisë. Është t’i japësh në dorë ekzekutivit kontrollin mbi këta.

Midis korporatizmit të theksuar dhe pavarësisë, në fund fare do të pranojmë diçka tjetër, që është më pak e dëmshme se pavarësia.

Me këtë propozim që bëjnë ekspertët, që nuk e kanë pasur këtë për shtjellim, në lidhje me antikushtetutshmërinë që ju sapo na thatë, ne jemi dakord.

Tani, e keni ndarë mendjen që të jetë ashtu? Qëndrimi politik është një gjë tjetër. Unë votat këtu për ta mbështetur propozimin tonë nuk i kam, as për propozimin e ekspertëve. Por të thuash që DSIK-ja dhe ILDKP-ja na garantojnë pavarësinë, kjo është për të vënë duart në kokë! Sigurisht, edhe formulimi i ekspertëve ndërkombëtarë parashikon, gjithashtu, që të dhënat dhe puna që bën ILDKP-ja, në rastin konkret, ose DSIK-ja, do të jenë patjetër pjesë e këtij procesi.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Oerd Bylykbashi – Por nuk mund të jenë ata që e bëjnë punën, e kryejnë ata vlerësimin. Kështu që, edhe një herë, shiheni se nuk është kështu siç thoni.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Tani po bëj një sqarim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Oerd Bylykbashi – Pra, unë mbështes propozimin që bëjnë ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Tani do të bëj një sqarim që të kuptohemi, pasi kam përshtypjen se është parimor në gjithë këtë diskutim që bëjmë.

Ju në parashtrësën tuaj paradite folët për një lloj korporatizmi që do të mund të krijohet, e quajtet “vëllazëri” brenda Prokurorisë së Posaçme...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...me arsyetimin tuaj.

Tani, ju bëni një superkorporatë me këtë që doni të bëni. Pse? Sepse ju kërkoni që këtë proces, që në fazën e parë do ta bëjnë komisionet e Kualifikimit, të vetingut e të tjerë, t’ua lini kontrollin vetë atyre në dorë. Pak më vonë propozoni që edhe kontrollin ndaj tyre ose hetimin ndaj tyre ta bëjë dikush tjetër, kurse përcaktimin e kushteve që plotësojnë ata, ta

bëjnë po vetë ata. Ndërkohë, ne e kemi të zgjidhur këtë gjë: faza e parë është me vetingun, pastaj këta emërohen nga Këshilli i Prokurorisë.

Këshilli i Prokurorisë, siç do të emërohen gjyqtarët, në momentin që do të bëjë emërimin e prokurorëve, do të vlerësojë, dhe nuk e vlerëson as ILDKP-ja, as ajo e parave, askush tjetër, por siç ndodh sot: bëhet gjyqtari dhe kushtet e gjyqtarit i verifikon Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nesër do t'i verifikojë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe këta do t'i vlerësojë Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Pra, të kuptohemi, në momentin që ai do të emërohet prokuror në Prokurorinë e Posaçme, kush e emëron atë në prokurori? E emëron Këshilli i Prokurorisë. Kjo do të thotë që ky Këshill do të bëjë vlerësimin dhe do të thotë: “Ky raport që më ka ardhur është objektiv, është me fakte? Po, do ta marr në konsideratë/nuk e marr në konsideratë” dhe do të vendosë emërimin. Nga radhët e prokurorëve do ta emërojë prokuror të posaçëm dhe logjika zgjidhet në vazhdimësi. Nuk ka nevojë për të bërë organ mbi organ, se pastaj do të vijë nesër dhe do të thonë: “Me leje? Edhe për gjyqtarët e Krimeve të Rënda të bëjmë një strukturë të posaçme, edhe për gjyqtarët të bëjmë brenda një strukturë të posaçme...”. Të dalin jashtë loje edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Pra, Kushtetuta dhe ligji kanë zgjedhur një periudhë transitore, që është vetingu i përgjithshëm i gjyqtarëve dhe i prokurorëve të Republikës, si dhe vazhdimësinë e procesit përmes strukturave permanente, që do të funksionojnë për vetërregullimin e sistemit dhe mbaroi. Pse duhet të shpikim gjëra të reja tani?

Arben Ristani – Për variantin që po debatohet, ekspertët ndërkombëtarë kanë rënë dakord?

Fatmir Xhafaj – Po ne ta thamë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka një pyetje për ju lidhur me debatin që bëhet. A keni një koment?

Jon Smibert – *(flet përkthyesi)* Për atë kohë të shkurtër që na u dha gjatë këtij pushimi, në qoftë se mund ta quajmë, i hodhëm një sy variantit të sjellë nga opozita dhe, gjithashtu, bëmë disa diskutime. Vumë re se në variantin e propozuar nga ne, i datës 8, ndoshta nuk kishim marrë parasysh disa boshllëqe që mund të krijohen, me anë të të cilave ndonjë prokuror mund të anashkalojë procesin e vetingut, duke ulur kështu standardin e

kontrollit të vetingut. Kështu, mund të na duhet pak më shumë kohë për t'u hedhur një sy këtyre shqetësimeve që qëndrojnë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Atëherë, le ta lëmë të hapur nenin 6 që të reflektojmë, vetëm se dua ta theksoj edhe një herë, nuk mund të kemi dy standarde brenda sistemit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, absolutisht.

Oerd Bylykbashi – Pandi, një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse e hapa unë mikrofonin përpara...

Shqetësimi është yni, zotëri!

Fatmir Xhafaj – Po, po.

Oerd Bylykbashi – Ajo që duhet të jetë e qartë nuk ka lidhje me standardet. Nuk ka standard të vetingut, atë e kemi zgjidhur; atë kapitull e kemi mbyllur me një ligj. Ky është një proces, i cili do të qëndrojë për një kohë të gjatë, duhet të jetë funksional dhe zgjidhja që japim ne është një zgjidhje që heq, shmang kontrollin e ekzekutivit nga procesi.

Sigurisht, problemi i një korporatizmi të theksuar mbetet, por nëse është kështu, do të mbetet kështu. Por kontroll nga ekzekutivi ne nuk pranojmë, e për rrjedhojë, çdo lloj zgjatjeje...

Fatmir Xhafaj – A e bëjmë këtë debat kur t'i vijmë prapë?

Oerd Bylykbashi – ...e cila kërkon të rikthejë institucionet që sot kanë probleme, ne nuk jemi të gatshëm ta pranojmë.

Sa kohë që ekspertët na kanë sjellë një draft, i cili për ne është i pranueshëm, ne jemi të gatshëm të mbështesim këtë propozim që bëjnë ekspertët e huaj.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Në qoftë se ne do të ecim me logjikën që kolegët e opozitës ngrenë, se nuk mund të ketë një reformë në kushtet që ekzekutivi mund të na e kontrolluara këtë reformën, ne do të kemi një problem shumë të madh, sepse thelbi i propozimit të nenit 6 është që, pavarësisht se kemi një nen kushtetues për atë që kryen ILDKP-ja në Republikën e Shqipërisë, ne do të krijojmë një dublifikim për të bërë atë që normalisht e bën ILDKP-ja; do

të bëjmë edhe një dublifikim tjetër, për të bërë atë që bën DSIK-ja. Ndërkaq, brenda reformës krijojmë përsëri edhe një ambiguitet: për procesin e vetingut e quajmë valid informacionin zyrtar, që marrim nga ILDKP-ja dhe DSIK-ja, ndërsa në ligjin që po flasim dhe pikërisht nenin 6 nuk i quajtkemi valide informacionet zyrtare që na vijnë nga ILDKP-ja dhe DSIK-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, a mund të vazhdoj unë tani?

Fatmir Xhafaj – Po.

Pandeli Majko – Ky dystandardizim, i cili bazohet thjesht në një logjikë politike, se ju apo neve nesër kur të dalim në opozitë nuk paskemi besim tek ekzekutivi, e çfarë pastaj? Më falni që po e bëj pyetjen ironike: e çfarë pastaj se nuk keni besim? Ky është sistemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...apo do të ecim me logjikat idiote që kemi prodhuar në këtë vend, që kemi çuar të numërojnë votat dhe kutitë e votimit Gjykatën Kushtetuese? E kemi bërë këtë, në mos gaboj, në vitin 2001 ose 2002-shin. Madje këtë e kemi bërë për të garantuar besim reciprok midis dy palëve se, me demokraci, ne nuk kishim besim te KQZ-ja. E çfarë doli ajo? Një vrimë në ujë!

Tani, unë mendoj se po diskutojmë një proces, i cili nuk ka të bëjë me një ekzekutiv, nuk ka të bëjë me një qeverisje, nuk ka të bëjë me një katërvjeçar, por ka të bëjë me të paktën 20 vjetët që do të vijnë.

Po ecëm me shpikje, do të përfundojmë me shpikje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po e përsëris edhe një herë, unë jam për nenin ashtu siç është: është një gjuhë e pastër, e qetë dhe nuk krijon asnjë lloj dublifikimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbi të gjitha, pse duhet të dyshojmë ne, të hedhim një dyshim ligjor, esencialisht ligjor dhe kushtetues, që ILDKP-ja nuk do ta zbatuaka Kushtetutën, DSIK-ja nuk do ta zbatuaka ligjin? Ç'është kjo? A nuk janë këto organe të afta të prodhojnë një dokument zyrtar...?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Ju doni që subjektivizmin tuaj se, po e citoj kolegun: “Nuk i lënka Edi Rama të japin informacion korrekt”...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të shkojë...?

Ai po falsifikoi dokumentin, do të shkojë në burg, mor zotëri! Kaq gjë nuk e kuptoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Jo. Të lutem tani! Nuk e diskutoj fare!

Fjalën e ka zoti Vasili dhe ky diskutim lihet i hapur për një ditë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petrit Vasili – Kam vetëm një fjali.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, ta them unë, e thuje... Tironas jemi të dy.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kam vetëm një gjë. Jua them prapë, duke vlerësuar shumë edhe konstruktivitetin që kemi këtu, në të gjitha rastet, kur kemi gjëra që hanë debat, në këtë rast patëm ndërhyrjen shumë të rëndësishme të zotit Smibert dhe e kemi çështjen të hapur, me besim të plotë të riformulimi apo sugjerimi, dhe ecim përpara me nenet, ju them shqip: nuk ka nevojë të

Distancat midis nesh nuk i mbushim dot në këtë gjë. Po t’i kishim këto mundësi, nuk do të kishim detyrimin që konsulenca ndërkombëtare të ishte vazhdimisht këtu. Përderisa është, atje ku kemi dhe ajo është e predispozuar ta thotë fjalën e saj, me besim të plotë vemi atje.

Le t’i japim ritëm kësaj pune, se kemi edhe gjashtë ligje të tjera. Të mos e harrojmë këtë gjë.

Keltis Kruja– Një fjali kam unë: zoti Majko, unë të ftoj ta lexosh propozimin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Seriozisht e kam, sepse nuk qëndrojnë fare ato që thatë, absolutisht, fare!

Është një propozim i cili për ne bazohet në parimet e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Duam ta bëjmë këtë reformë? Ta bëjmë sa më mirë. Nuk ka lidhje fare me debatin politik, me ato që thoni ju.

Kemi ose jo besim te Kryeministri, kjo është çështje tjetër.

Që nuk kemi, e dini ju këtë, por propozimi që kemi bërë ne nuk lidhet fare-fare me debatin politik të ditës.

Ju ftoj ta lexoni, lexojeni...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e lexove, se e the vetë: “Nuk e kam lexuar, se kam nenin tim”. Ndaj, lexoje dhe do ta kuptosh se nuk ka lidhje fare me ato që the.

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja Hysi dhe e mbyllim këtë gjë.

Vasilika Hysi – Meqenëse ekspertët do ta rishikojnë nenin 6, kam një sugjerim që thjesht kam idenë se është gabim në shtypje: te paragrafi i dytë, ku thuhet: “Kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimin janë...” ka dy pika. Duhet bërë numërimi: a), b) dhe c).

Fatmir Xhafaj – Për këtë kishe merak ti?

Vasilika Hysi – Po.

Fatmir Xhafaj – Po kur të bëhet nga e para, se na harxhove kohën.

Vasilika Hysi – Thashë ta kenë në konsideratë edhe këtë.

Fatmir Xhafaj – Ka të drejtë zoti Vasili pastaj.

Atë e kanë bërë në rishikim.

Vasilika Hysi – Jo.

Fatmir Xhafaj – Të lutem tani, mos humbisni kohë!

Atëherë, neni 6 do të riformulohet duke reflektuar mbi debatin që u bë këtu dhe duke mbajtur parasysh parashikimin kushtetues sigurisht.

Në rregull, vazhdojmë me nenin 7 “Procesi i hapur dhe transparent i aplikimit”.

Ulsi Manja – Shprehemi dakord me nenin 7.

Vasilika Hysi – Vetëm redaktime...

Fatmir Xhafaj – Shumë dakord jemi ne këtu, por formulimi është paksa... “Proces i hapur dhe transparent” përfshin minimalisht aplikimin, hapësirën, që në fjalorin e konceptit tonë është hapësirë fizike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që duhet riformuluar për ta gjetur shqip.

Ulsi Manja – Shprehemi dakord me riformulimin që do t’i bëhet nga ana e teknikës legislative.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 7, për ta parë nga pikëpamja e terminologjisë.

Neni 8 “Kompetencat tokësore”. Keni ndonjë gjë lidhur me kompetencat tokësore?

Ulsi Manja – Jo, neni 8 është “Kompetenca parësore” dhe shprehemi dakord.

Vasilika Hysi – Vetëm për redaktorët.

Ulsi Manja – Po, është kompetenca parësore, jo tokësore.

Fatmir Xhafaj – Pse “tokësore” thashë unë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord me nenin 8.

Neni 9?

Ulsi Manja – Në nenin 9, paragrafi i parë, gjithmonë për të mos lënë, për ta bërë dallimin e “kompetencës parësore” me kompetencat e tjera, propozoj të hiqet fjala “kjo ka rëndësi” dhe të thuhet: “Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo veprë penale tjetër, që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Ulsi Manja – Pra, të hiqet fjala “rëndësi” në fjalinë “vepra penale që ka rëndësi”.

Fatmir Xhafaj – Po.

Ulsi Manja – Se nuk ka vepra penale të rëndësishme dhe të parëndësishme.

Fatmir Xhafaj – Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull.

Faleminderit! Miratohet, me ndryshimin.

Neni 10 “Juridiksioni kombëtar”?

Ulsi Manja – Shprehemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 11 “Prokuroria e Posaçme”.

Ulsi Manja – Shprehemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Po?

Oerd Bylykbashi – Ky nen është gjithmonë në lidhje me atë që diskutuam për sa i përket, po themi, pavarësisë së... Ne gjykojmë që fjalia e fundit e paragrafit 3 duhet hequr, është e tepërt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fjalia e dytë e paragrafit 3.

Fatmir Xhafaj – Nuk janë dakord.

Në rregull. Miratohet, siç është.

Neni 12?

Ulsi Manja – Shprehemi dakord në variantin siç është në draft.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka një sugjerim, por që shkon në vazhden, lidhet me nenin...

Fatmir Xhafaj – ...nenin 6. Do të reflektojë nenin 6 në qoftë se do të ketë ndryshime.

Ulsi Manja – Presim një përgjigje.

Oerd Bylykbashi – Ka një amendament.

Ulsi Manja – Është reflektim, por që lidhet me nenin 6...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të presim një përgjigje edhe për këtë.

Vexhi Muçmataj – Dakord.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ka një amendament nga ana jonë që...

Ulsi Manja – Po pra, do të presim përgjigjen.

Oerd Bylykbashi – Nuk e dëgjova.

Vexhi Muçmataj – Për atë po flisja.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Muçmataj.

Vexhi Muçmataj – Te neni 12 mendoj se titulli “Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme” mund të thuhet: “Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme”.

Fatmir Xhafaj – Po...

Vexhi Muçmataj – Po kështu, edhe në paragrafët më poshtë, ku thuhet: “Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme” të hiqet fjala “të posaçëm” sepse është, dublohet. Në të gjithë paragrafët...

Fatmir Xhafaj – Duhet pastruar nga këto, se kuptohet, prokurorë të Prokurorisë së Posaçme...

Nuk ka gjë, se i bie që prokurorët e posaçëm brenda Prokurorisë së Posaçme në analizën e tekstit gjuhësor.

Dakord me nenin 12, me redaktimet dhe do të replikojë ndryshimin që do të bëhet te 6-a.

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E thashë pra!

Vasilika Hysi – Po pra, do të reflektojë ndryshimin e 6-ës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Do të mbetet e hapur ajo.

Fatmir Xhafaj – E kam thënë pesë herë deri tani, çfarë të them tani?

Neni 13 “Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme”.

Ulsi Manja – Në nenin 13, paragrafi i tretë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po, ke të drejtë.

Ulsi Manja – Ne sugjerojmë riformulimin e paragrafit të tretë të nenit 13 si më poshtë: “Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm, të brendshëm apo të jashtëm, nga çdo autoritet publik a privat.”

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, është neni i famshëm që...

Ulsi Manja – Ajo që ka të bëjë me medien.

Oerd Bylykbashi – Kam një pyetje për Ulsin. U pendove që ishte bërë herën e parë ashtu...

Fatmir Xhafaj – Po, po, u pendua dhe në shenjë pendese...

Oerd Bylykbashi – ...që kishe cenuar lirinë e medies?

Fatmir Xhafaj – E kam thënë, por ti përpiqesh.

(Ndërprerje incizimi)

Vexhi Muçmataj – A mund të bëj një sugjerim, të lutem?

Fatmir Xhafaj – Po.

Vexhi Muçmataj – Te pika 1 “Në ushtrimin e funksioneve të tyre prokurorët veprojnë dhe marrin vendime”, tani i vetmi vendim që merr prokurori në veprimtarinë e tij procedurale, kur ka filluar procedimi penal, është vendimi i pushimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ata gjatë hetimeve...

Fatmir Xhafaj – Ç’rëndësi ka? A ka një vendim?

Vexhi Muçmataj – Ka, por jo, më falni, se është përmbajta.

Ata bëjnë më shumë kërkesa, për shembull, siç janë kërkesat për vlerësimin e masës së sigurimit, kërkesa për caktim mase sigurimi, kërkesa për ndryshim mase...

Fatmir Xhafaj – Po, veprime janë, por...

Vexhi Muçmataj – Pra, duhet ta riformulojmë ndryshe.

Mendoj: “Prokurorët bëjnë kërkesa dhe marrin vendime”.

Fatmir Xhafaj – Veprim është ai, e përfshin.

Vexhi Muçmataj – Jo, vendim nuk është, kërkesa është ndryshe...

Fatmir Xhafaj – Por është pjesë e... veprimtarinë. Ideja e kësaj është që janë të pavarur në të gjithë veprimtarinë e tyre, por e kanë theksuar vendimi.

Vexhi Muçmataj – Jo, veprojnë, se veprojnë është një gjë, kërkesë është një tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendoj ta formulojmë: “...bëjnë kërkesa dhe marrin vendime”.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Hoxha.

Artan Hoxha – Riformulimi i paragrafit të tretë, se unë dakord jam që të biem dakord me medien, por duhet edhe pak kështu...

“Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit, nga prokurorët, të funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore, pavarësisht

ndikimit të paligjshëm, të brendshëm apo të jashtëm, duke ndaluar ndikimin e vet”, jo pavarësisht. Domethënë, duke ndaluar ndikimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Fatmir Xhafaj – Jo, se nuk është qëllim që të ndalojnë.

Vexhi Mucmataj – Ajo ka ndodhur.

Fatmir Xhafaj – Të pandikueshëm, pra një gjë që kuptohet se nuk je i ndikueshëm.

Artan Hoxha – Nuk është ligji, se ligji nuk garanton në vetvete po të jetë se nuk ka një rregullim përkatës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nëpërmjet sanksioneve, nëpërmjet rregullimeve të posaçme ligjore, por kështu si është, nuk thotë asgjë, po ta marrësh...

Fatmir Xhafaj – Parim është ai.

Artan Hoxha – Por nuk thotë gjë, thjesht përsërit vetveten.

Fatmir Xhafaj – Edhe ajo që thoni ju nuk qëndron.

Artan Hoxha – Kjo që them unë, mundohem brenda këtij teksti, por...

Fatmir Xhafaj – Po pra.

Artan Hoxha – Me sa mbaj mend, kanë qenë tri versione.

Fatmir Xhafaj – Kemi marrë versionin e tretë.

Artan Hoxha – Ndërkohë, versioni i dytë është shumë i saktë, sepse është ndërkombëtar.

Fatmir Xhafaj – Ai është një diskutim i mbyllur. Nuk duhet t’i hyjmë prapë një gjëje sa të sqarojmë gjithë këta njerëz, që bëjnë sikur kuptojnë gjëra të mëdha, por nuk kuptojnë asgjë, hapet një zhurmë prapë nga e para...

Artan Hoxha – Nuk ka kuptim që ligji të garantojë pavarësinë, pavarësisht ndikimit të paligjshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht pra, por nuk është shkruar kështu, se ne i themi me fjalë të tjera. por nuk mund të thuash: ligji garanton pavarësinë, pavarësisht ndikimit. Domethënë, e pranojmë ndikimin, se po të shkojmë në gjuhë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por ndërkohë e garantojmë.

Ne nuk e lejojmë ndikimin, është thelbi i gjësë.

Petrit Vasili – Më falni, të bëj një pyetje... Ore, ndikimi, që në momentin që e themi, ekziston.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prit, lëre pjesën e parë!

Ne e kemi ingranuar, i kemi dhënë të kuptojë që kjo punë do të ecë pavarësisht se kjo që ndodh, Pastaj i paligjshmi do ta marrë dënimin sipas ligjeve që kemi.

Po thamë ndikimin, ose nuk e pranojmë fare që nuk ka ndikim në këtë vend, se kemi vënë barriera dhe ndikimi nuk mund të ndodhë, ose po ndodhi, themi: ky ecën përpara në punët e tij, është i pavarur për këtë punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është...

Fatmir Xhafaj – Po?

Vasilika Hysi – Mua më duket se shqetësimi i zotit Hoxha është i drejtë.

Ligji flet për pavarësinë e prokurorëve.

Fatmir Xhafaj – Të mos e zgjasim për ata që nuk e kuptojnë...

Vasilika Hysi – Te neni 3 nuk mund të themi se ligji garanton, por do të themi: “Prokurorët, në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore, janë të pavarur dhe autonomë, pavarësisht ndikimit të paligjshëm, të brendshëm dhe të jashtëm, nga çdo autoritet publik dhe privat”. Hë, Tani?

Oerd Bylykbashi – Kam përshtypjen se shqetësimi mbetet prapë.

Formulimi që është këtu pranon ekzistencën e ndikimit dhe thjesht duket sikur e shmang, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndoshta ky formulim: “Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor nga ndikimi i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm, prej çdo autoriteti publik a privat”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

E mbyllëm atëherë, dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, “nga ndikimi”.

Ulsi Manja – “Pavarësisht nga ndikimi”.

Fatmir Xhafaj – “Nga ndikimi i paligjshëm”, në rregull.

Ecim.

Neni 14 “Përgjegjshmëria”.

Miratohet neni 13, me ndryshimin...

Oerd Bylykbashi – Më falni, një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Te neni 14, pas presjes, është shtuar fjala “gjithashtu” me të kuqe.

Fatmir Xhafaj – Po, “gjithashtu”.

Dakord? Dakord.

Neni 15?

Ulsi Manja – Shprehemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Ky nen nuk më duket shumë i qartë. Ndoshta marrëdhëniet e Prokurorisë së Posaçme me Byronë Kombëtare të Hetimit, pastaj thotë: Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme drejtojnë punonjësit e Prokurorisë së Posaçme”, ndërkohë që neni flet vetëm për marrëdhëniet me Byronë.

Ju i...

Ulsi Manja – Kjo fjalë është fakultative, do ta riformulojmë që të jemi korrektë.

Fatmir Xhafaj – Duhet bërë një riformulim.

Dakord?

Neni 16.

Vexhi Muçmataj – Zoti kryetar, a mund të bëj një sugjerim?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Po pra, e thamë.

Vexhi Muçmataj – Mendoj se neni 15 duhet suprimuar, duhet hequr, sepse është ezauruar te neni 5, kur thamë funksionet e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, që të kuptohemi, ideja këtu nuk është se është harruar një fjalë, ideja është: marrëdhëniet e Prokurorisë së Posaçme me punonjësit e Prokurorisë së Posaçme, me punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe shërbimeve. Pra, bëhet fjalë për stafin teknik, jo me institucionet. Titulli është formuluar gabim.

Vexhi Muçmataj – Këto marrëdhënie janë rregulluar në nenet që vijojnë pastaj.

Fatmir Xhafaj – Po pra, por kjo u hap rrugë atyre.

Vexhi Muçmataj – Janë rregulluar specifikisht.

Fatmir Xhafaj – Bëni një riformulim me zotin Manja.

Ulsi Manja – Shprehem dakord për ta riformuluar nenin 15.

Fatmir Xhafaj – Neni 16 “Drejtuuesi i Prokurorisë së Posaçme”.

Oerd Bylykbashi – Kemi një amendament.

Ulsi Manja – Shprehemi dakord me nenin 16.

Oerd Bylykbashi – Një sekondë!

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi ka...

Oerd Bylykbashi – Në nenin 16, në paragrafin 2, në funksion të asaj që ngritëm si çështje themelore, pavarësinë e këtyre organeve, ne propozojmë që të bëhen ndryshime sipas këtij propozimi: në germën “b” shprehja “Në njësinë hetimore në Policinë e Shtetit” shfuqizohet, hiqet dhe në germën “ç” shprehja “Shërbimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore” të shfuqizohet. Pra, ne jemi të logjikës që këto janë struktura, siç thuhet në nenin përkatës, të brendshme të njësisë e për rrjedhojë nuk mund të jenë jashtë Njësisë së Posaçme Hetimore.

Fatmir Xhafaj – Por me ju nuk është dakord zoti Muçmataj.

Oerd Bylykbashi – Është në lidhje me shqetësimin që ngremë për pavarësinë e organit.

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Më falni, nuk e kisha ndezur!

Kolegë të opozitës, ju jeni në kundërshtim.

Në një amendament më parë ju thatë: “Njësitë e Posaçme janë një strukturë e pavarur e specializuar, që ushtrojnë atributet e Policisë Gjyqësore”, kurse tani në germën “ç” thoni që këta nuk kanë të drejtë t’i paraqesin Ministrisë së Financave buxhetin dhe pagat për

shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Do t'i lini pa rroga punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit? Kjo nuk shkon!

Oerd Bylykbashi – Duke qenë se paguhen nga struktura, janë pjesë e brendshme e strukturës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur ta bëjë për të gjithën, e bën për strukturën e vet ajo.

Petrit Vasili – A ka gjë më të thjeshtë në botë se kjo pikë? I paraqet Ministrisë së Financave buxhetin e prokurorisë së posaçme të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Pse komplikohemi kaq shumë? Kjo është zgjidhja më e thjeshtë. Ky është një institucion integral që i ka të detajuara në buxhet të gjitha zërat që ka. Këtu mbaron si për çdo institucion tjetër. Ky nuk dallon nga të tjerët, për sa u takon raporteve buxhetore. Këtu shteron debati i kotë. Nuk ka nevojë të bëjmë debat më tej.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Ulsi Manja – Lidhur me nenin 16, pika “b”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili – A jeni dakord ta shterojmë këtu debatin për buxhetin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Lidhur me nenin 16, te pika “b”, unë kam përshtypjen se lidhur me mënyrën si është formuluar, mund të krijohet një keqkuptim, sepse bëhet fjalë për dy njësi të posaçme hetimore: njëra që është në BKH dhe tjetra që është në Policinë e Shtetit. Në fakt këtu mund ta riformulojmë *mot a mot*, siç e përcaktuam te neni 5 i ligjit: “U cakton çështjet prokurorëve të posaçëm bazuar në specializimin e tyre dhe vendos lidhur me juridiksionin respektiv të hetimit midis oficerëve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore”.

Fatmir Xhafaj – Ka dashur ta ndajë. Logjika është kjo: prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, shpeshherë krijojnë konflikte ndërmjet strukturave të Policisë Gjyqësore, pra të asaj policie gjyqësore që do të jetë te BKH-ja dhe të shërbimeve që do të jenë te Policia e Shtetit. Ideja është se kush e ndan juridiksionin respektiv. Është rënë dakord që këtë ta ndajë drejtori i Prokurorisë së Posaçme. Kjo është e qartë.

Urdhëroni!

Vexhi Muçmataj – Te pika “b” mund të mos thuhet: “njësia hetimore”, por të thuhet: “shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe në institucionet e tjera”, sepse shërbime të Policisë Gjyqësore do të ketë te tatimet, te doganat, pra duhet ta shtojmë: “edhe në institucione të tjera”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Në Policinë e Shtetit dhe në institucione të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S’ka ndarje.

Oerd Bylykbashi – Ju po kërkon ta ndani. Pra, do të ketë një pjesë që varet drejtpërdrejt nga këta dhe një pjesë që varet nga drejtori i Përgjithshëm i policisë dhe nga drejtori i përgjithshëm i Doganave. Kjo është çështja që kemi në themel për këtë pikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, që ta kuptoni: do të lindin shpesh në praktikë konflikte juridiksionale ndërmjet prokurorëve të zakonshëm dhe prokurorëve specialë dhe ndërmjet oficerëve të Policisë Gjyqësore të BKH-së dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore të Shtetit. Këtë konflikt juridiksional do ta zgjidhë drejtori i SPAK-ut. Me kaç mbaron.

Atëherë, me ndërhyrjen te pika “ç” dhe duke hequr fjalinë e dytë: “si dhe për pagat...”, sepse nënkuptohet.

Pikën “b” do ta riformulojmë, siç e paraqiti Vexhiu.

Vexhi Muçmataj – Zoti kryetar, insistojmë për pikën “b”: “dhe shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe në institucione të tjera.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po, ka edhe te doganat, edhe te tatimet. Ka konflikte nga më të ndryshmet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni edhe një herë, sepse ju nuk po e kuptoni si funksionon. Nuk jua kanë sqaruar qartë. Në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë disa polici gjyqësore. Mund të jenë disa çështje në proces dhe mund të krijohen disa konflikte juridiksionale midis tyre. Kush do ta zgjidhë konfliktin midis tyre? Policia Gjyqësore e Tatimeve mund të thotë se është çështja e

saj, ndërsa Policia Gjyqësore e BKH-së mund të thotë: “Jo është në kompetencën time”. Kush do ta zgjidhë konfliktin? Shikoni filmat amerikanë, ku ka raste ku zihen prokurorët federalë me prokurorët e FBI-së.

Petrit Vasili – Megjithatë, ka një problem: meqenëse kemi një rreze bashkëpunimi kaq të madhe, sigurisht, e krijojmë vetë problemin kur themi: “Policia Gjyqësore te Policia e Shtetit” dhe më pas krijojmë vetë probleme me doganat dhe me të tjerët. Ose do të duhej t’i nominonim të tëra, ose ta presim aty, sepse ky bashkëpunim është i detyruar.

Fatmir Xhafaj – Konfliktin e zgjidh drejtori, se ia lamë atij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Byroja Kombëtare e Hetimit do të ketë në dispozicion dhe në përbërjen e saj edhe shërbimet e Policisë Gjyqësore dhe këto shërbime nuk i ka vetëm Policia e Shtetit, por ka edhe institucionet e tjera. Këtu do të rekrutohen që të gjithë dhe do të jenë në varësi të BKH-së. Këta do të kenë edhe varësi procedurale, edhe varësi administrative dhe pagën do ta marrin te drejtori i BKH-së.

Oerd Bylykbashi – E ka pjesë përbërëset vet, thotë neni tjetër.

Fatmir Xhafaj – Dakord me versionin që është dhënë? Kush është kundër? Zoti Bylykbashi është kundër.

Miratohet.

Neni 17, “Mbledhja e prokurorisë së posaçme”.

Keni gjë për nenin 17?

Vexhi Muçmataj – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Kisha një pyetje për ekspertët: Në pikën 5 keni thënë: “Vlerësojnë çështje të personelit, të disiplinës, të sigurisë apo çështje të tjera.” Nuk i zgjidh drejtori këto, por duhet t’i zgjidhë mbledhja e përgjithshme? Ky është koncepti juaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të mblidhet kolektivi të zgjidhë çështjet personale?

Nëse kjo funksionon, nuk kemi ndonjë gjë parimore. Thjesht po pyesim: Mos nuk është praktike? Është në rregull për ju?

Si ta çmoni.

Korajlka Bumci – *(flet përkthyesi)* Mendoj ta lëmë kështu siç është këtë nen, sepse kështu e kemi te ligji “Për prokurorinë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, sepse kuptimi ishte i kundërt. Mendoj se nuk ka nevojë për këtë nen, sepse e kemi te ligji “Për prokurorinë”.

Fatmir Xhafaj – Dakord jemi të hiqet. Riformulojeni me ndryshimet e propozuara!

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 18, “Struktura e Prokurorisë së Posaçme”.

Ulsi Manja – Jemi dakord me strukturën.

Fatmir Xhafaj – Kam një merak, zoti Smibert, zonja Bumçi, dhe zoti Hoxha, se ju jeni ekspertë të fushës dhe ndoshta e dini më mirë: Duke i përcaktuar në ligj, mos po i lidhni duart vetes nesër, nëse doni të krijoni apo të paktën duhet shtuar: “Mund të krijohen seksione të tjera, që mund të jenë të nevojshme në praktikë.” Kështu siç është, u lidhni duart dhe nuk mund të bëni gjë tjetër nesër. Sot keni 4 seksione. Nesër mund t’ju duhet të formoni 6 seksione. Bëni si të doni, se unë nuk jam as ekspert i prokurorisë së posaçme, as i prokurorisë.

Korajlka Bumci – *(Flet përkthyesi)* Edhe mund ta ndryshojmë, duke u bazuar tek ajo që thatë ju, por ne e kemi marrë ashtu siç është te struktura e USKOK-ut. Gjithsesi, një gjë që na ka shpëtuar, është në lidhje me administratën.

Fatmir Xhafaj – A mund t’ju lëmë kohë për ta riformuluar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çdo seksion tjetër, që lind si i nevojshëm.

Dakord, riformulojeni nenin 18! Jeni dakord zonja Bumçi? Dakord. Faleminderit!

Neni 19, “Kancelari dhe Seksioni i Dokumentacionit”.

Ulsi Manja – Jemi dakord me nenin 19 me shtesën që është bërë: “Mbikëqyr personelin administrativ”.

Fatmir Xhafaj – A ka gjë opozita për nenin 19? S’ka.

Dakord.

Faleminderit!

Neni 20, “Seksioni i Dokumentacionit” me ndryshimin e paraqitur.

Ulsi Manja – Jemi dakord me nenin 20.

Fatmir Xhafaj – Koncepti është që krijon është një *data base* për rastet e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Jeni dakord me nenin 20?

Dakord.

Faleminderit!

Neni 21, “Seksioni i Ekspertizës”.

Jeni dakord me nenin 21?

Dakord.

Faleminderit!

Neni 22, “Seksioni i Hetimit Financiar”.

Keni gjë për këtë nen?

Ulsi Manja – Jemi dakord me nenin 22.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Miratohet.

Neni 23, “Seksioni i Hetimit Ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta”.

Ulsi Manja – Jemi dakord me nenin 23.

Fatmir Xhafaj – Më falni, por në një vend është shkruar “sektor” dhe në një vend është shkruar “seksion”.

Vasilika Hysi – Kemi thënë që do ta rregullojmë nga ana gjuhësore.

Ulsi Manja – Kemi rënë dakord për unifikimin e termave edhe në ligjin “Për prokurorinë”, edhe në këtë ligj.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Moza, duhet t’i unifikoni termat “sektor” dhe “seksion”!

Miratohet neni 23, “Seksioni i Hetimit Ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta”.

Neni 24, “Detyrat e ndërlidhësit”.

Jeni dakord me nenin 24?

Ulsi Manja – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 25, “Koordinatori për Marrëdhënien me Mediet”. Kjo është një risi shumë e mirë.

Ulsi Manja – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 26, “Seksioni për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm”.

Ulsi Manja – Jemi dakord me këtë nen.

Vasilika Hysi – A mund të bëj një pyetje për këtë nen?

Fatmir Xhafaj – Më falni! Kërkoj ndjesë, se te neni 22 keni vënë fjalën “llogaritar”.

Nuk ka diploma për llogaritar në Republikën e Shqipërisë, por për financier.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Për *counting* është audit.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord, e lëmë financier.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, për nenin 26!

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 26, mendoj se është në rregull si nen, por te pika 3 thuhet: “Koordinatorët do të kenë diploma nga një universitet i licencuar, në degët e psikologjisë, sociologjisë, apo degë të tjera të lidhura me këtë fushë”. Mendoj se nuk është i mjaftueshëm kushti që të kenë diploma nga një universitet i licencuar, sepse universitetet e palicencuara i kemi mbyllur tashmë.

Ne kemi miratuar në parlament ligjin “Për Urdhrin e Psikologut”, i cili është një profesion i rregulluar, ashtu si edhe për punonjësit socialë që është gjithashtu, një profesion i rregulluar dhe kriteri që është që jo vetëm duhet të ketë diplomën, por duhet të plotësojë edhe kriteret e urdhrin përkatës, sepse është një ligj i posaçëm. Pra, të gjithë personat që do të punojnë si psikologë apo punonjës socialë, duhet të plotësojnë disa kriteret, që lidhen me profesionet e rregulluara. Nuk e di pse i keni anashkaluar kërkesat e ligjit për profesionet e rregulluara.

Nëse nuk mund të përgjigjeni sot, mund ta lëmë të hapur, për të parë nëse kërkesat e atij ligji i përshtaten, apo jo. Ai ligj kërkon një cilësi shumë më të mirë, disa kriteret shumë më të mira, sesa thjesht një diplomë.

Oerd Bylykbashi – Çështjet që ngrihen këtu nuk janë thjesht, në është i licencuar universiteti apo jo, por kemi të bëjmë me nivelin e formimit. Kemi të bëjmë me diplomë

universitare dhe jo me kurs formimi që dikush të vijë dhe të thotë që është edhe psikolog. Duhet të jetë një diplomë universitare dhe sigurisht, që duhet të jetë universitet i licencuar.

Ulsi Manja – Jemi dakord me këtë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 26 u miratua me ndryshimin e propozuar, ndërsa neni 27 u miratua siç është .

Neni 28, “Pushimi i çështjeve ose akuzave nga prokurori i posaçëm”.

Keni ndonjë gjë për këtë nen?

Urdhëroni, zoti Muçmataj!

Vexhi Muçmataj – Mendoj se formulimi i këtij neni vjen në kundërshtim të hapur me pikën 1, të nenit 13 të këtij ligji, ku thuhet se prokurori është i pavarur në marrjen e vendimeve, ndërsa në këtë nen, krijohet një procedurë ekstra, të cilën nuk po e lexoj, por mendoj se duhet ta korigjojme në frymën e pikës 1, të nenit 13 të këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Ulsi Manja – Ideja e kolegut Muçmataj është që mbledhja e përbashkët e prokurorëve të prokurorisë së posaçme merr kompetenca procedurale. Kjo gjë bie ndesh me formulimin e pikës 1, të nenit 13 të këtij ligji, sepse prokurori i prokurorisë së posaçme është ai që vendos mbi fatin e përfundimit të hetimit dhe jo mbledhja e përgjithshme e prokurorëve.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me këtë?

Oerd Bylykbashi – Besoj se qëndron shqetësimi që ngritën dy kolegët parafolës.

Nga ana tjetër, jemi të mendimit që është gjithmonë ky prokuror, i cili merr vendim më pas, për ta pushuar një çështje. Këtu hapet problemi që duhet të shohim sa hapësira ka, sepse ndoshta nuk ka që këta prokurorë do të marrin një pavarësi të jashtëzakonshme dhe kur të vijë kjo në çështjet e hetimit brendapërbrenda radhëve të tyre, këta prokurorë nuk do të kenë asnjë lloj kontrolli dhe mund t’i hapin dhe t’i mbyllin çështjet si të duan.

E dyta, jemi gjithsesi, para një të drejte të prokurorëve për të hapur dhe për të mbyllur çështjen, që është praktikisht *de facto* dhënie drejtësie dhe praktikisht, është e gabuar. Ne nuk kemi edhe sot asnjë tjetër filtër dhe garanci. Sot mesa duket, po vihet kështu për të mos ta lënë në dorë të prokurorit, por jemi në cenim të pavarësisë së prokurorit individual. Kjo në fakt nuk është çështje prokurorësh, por është çështje drejtësie.

Fatmir Xhafaj – Ne kemi rënë dakord që vendimi i pushimit do t'i nënshtrohet edhe gjykatës.

Oerd Bylykbashi – Nëse është rënë dakord kjo, i zë rrugën dhe e parandalon këtë gjë.

Fatmir Xhafaj – A kanë ekspertët ndonjë gjë për të shtuar?

Urdhëroni, zoti Hoxha!

Artan Hoxha – Qëndrimi im personal është që neni 28 nuk është dispozitë e përshtatshme për një ligj organik, sepse kjo është dispozitë procedurale. Mënyra e përfundimit të çështjes, pushimi, mosfillimi, kalimi për gjykim, janë aspekte fundore të hetimit paraprak.

Fatmir Xhafaj – Dakord, riformulojeni me kujdes dhe ta shohin edhe zonjat eksperte, që të jemi korrektë, sepse ato janë bashkautore të këtij ligji!

Artan Hoxha – E dyta që desha të them, është se ka një problem me pavarësinë e prokurorit, sepse ajo mbulohet në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve dhe elementi i reformës është që prokurori në vendimmarrjen e tij duhet të jetë i pavarur së jashtmi dhe së brendshmi dhe në një farë mënyre, këtu e mbulojmë përgjegjësinë e prokurorit nëpërmjet mbledhjes dhe ajo që është më e rëndësishmja, është se çdo vendim i prokurorit është i atakueshëm në gjykatë.

Për efekte garancie, edhe gjykata së cilës i drejtohesh për t'u ankuar ndaj një vendimi pushimi, është edhe ajo një gjykatë e specializuar. Edhe ajo ka marrë procesin e vetingut, që të kemi gjyqtarët më të mirë etj., e cila vendos në lidhje me një vendimmarrje të prokurorit që është në vendimmarrjen e tij, që është gjykata e posaçme. Këtu vijmë në një diskutim tjetër që është më i gjerë, lidhur me gjyqtarin e veprimeve paraprake, nëse do ta fusim si figurë procedurale, apo jo. Ky është një diskutim tjetër që lidhet me Kodin e Procedurës Penale, por çfarëdo lloj emri t'i vëmë atij gjyqtari, ai është garantuesi i verifikimit të ligjshmërisë së vendimit të prokurorit. Ne jemi ndarë këtu, si ekspertë në diskutime. Mendimet i kemi pasur të diskutueshme me njëri-tjetrin.

Këtu kemi shkuar në drejtim të garancisë që një vendim kur pushohet, duhet të pushohet në mënyrë kolektive. Ndërkohë, kjo ka edhe rrezikun tjetër që kolektivin mund ta përdorë edhe për vendime të kundërligjshme.

Fatmir Xhafaj – Të mos diskutojmë më tej! Biem dakord të gjithë që ka nevojë për t’u riparë, por unë dua që riformulimi të çekohet më parë nga zoti Smibert dhe nga zonja Bumçi, sepse ne po flasim shqip dhe mund të ketë vështirësi përkthimi. Ta çekojnë më pas këta, të mos kemi më probleme, për këtë çështje, por në parim biem dakord që të riformulohet.

Faleminderit!

Neni 29, “Ankimi”.

Ulsi Manja – Jemi dakord me nenin 29.

Oerd Bylykbashi – Këtu është thënë: “Në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit”, por problemi është që ne kemi gjykata të posaçme për këtë punë.

Ulsi Manja – Përderisa organizimi i prokurorisë së posaçme do të jetë me një trupë prokurorësh, të cilët do të përfaqësojnë akuzën të tria shkallët e gjykimit.

Oerd Bylykbashi – Dakord, nuk kam problem me atë, por këtu thuhet: “Në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit”, nuk e specifikon.

Ulsi Manja – Në gjykatën e shkallës së parë flitet për gjykatën e posaçme...

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk thuhet.

Ulsi Manja – Do ta specifikojmë që bëhet fjalë për gjykatën e posaçme të shkallës së parë dhe atë të apelit.

Fatmir Xhafaj – Për nenin 29, të specifikohet se për cilën gjykatë bëhet fjalë.

Ulsi Manja – Jam dakord me sugjerimin e kolegut Bylykbashi.

Fatmir Xhafaj – Te pika 2 kam diçka. Ju thoni: “Prokurorë të tjerë të posaçëm të Prokurorisë së Posaçme ose, me kërkesë të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme ndihmojnë prokurorët e posaçëm për të përgatitur dhe mbrojtur apelimet, kur është e nevojshme.”

A mund të ma shpjegoni sesi prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme do të ndihmojnë prokurorët e prokurorisë së posaçme për të përgatitur dhe mbrojtur apelimet, kur është e nevojshme, se nuk e shpjegoj dot këtë?

Ulsi Manja – Edhe pika 2, e nenit 29 kërkon një riformulim për të dalë në pah ideja që prokurorët e prokurorisë së posaçme, për të përgatitur ankimin në Gjykatën e Apelit, mund të mos jetë domosdoshmërisht prokurori që ka ndjekur hetimin e çështjes dhe që e ka

përfaqësuar akuzën në gjykatën e shkallës së parë, por mund të jetë një prokuror tjetër i po asaj prokurorie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ideja ka qenë që prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme mund të asistojë apo mund të ndihmojë një prokuror të SPAK-ut në përgatitjen e ankimit për në Gjykatën e Lartë.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Ulsi Manja – Kështu është parë, sepse prokurorët kanë një farë impenjimi tjetër pranë Gjykatës së Lartë.

Urdhëroni, zoti Muçmataj!

Vexhi Muçmataj – Mendoj se ka një farë diference të këtij neni me nenin 4, ku thuhet qartë, se prokurorët e Prokurorisë së Posaçme përfaqësojnë akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe para Gjykatës së Lartë. Kjo është e përcaktuar qartë.

Fatmir Xhafaj – A mund të na e sqaroni këtë paragraf?

Vexhi Muçmataj – Neni që po diskutojmë lë shteg për një diferencë, që të futen këtu, edhe prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Vexhi Muçmataj – Është pa asnjë arsye.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Për këtë po pyes.

Dakord, që të mos përsërisim.

Kishit ndonjë gjë tjetër për të thënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Smibert!

Jon Smibert - *(Flet anglisht)*

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Flet përkthyesi) Pra, arsyeja kryesore e paragrafit nr. 2 është për t'i dhënë më shumë fleksibilitet, më shumë mundësi.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

A mund ta bëjmë që të mos jetë vetëm prokurori i Prokurorisë së Posaçme, por të bëhet në bashkëpunim me prokurorin e Përgjithshëm. Se kështu i bie që ai është titullar i institucionit tjetër, ndërsa ky i thotë që këtë do ta marr unë se do të më bëjë ankimin. E thënë kështu...

Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Duke ndarë shqetësimin që po ngrenë kolegët, edhe pas shpjegimit të zotit Smibert, këta prokurorë për shkak të nevojës, mund të përfitojnë nga dija dhe përvoja e prokurorëve të tjerë dhe në çdo rast, përtej utilitetit të kësaj zgjidhjeje, mbetet shqetësimi kryesor, sepse duket sikur dispozita i jep një kompetencë urdhërdhënëse prokurorisë së posaçme mbi Prokurorinë e Përgjithshme. Sa herë të ketë nevojë, mund të marrin prokurorë, ndërkohë që të dyja këto janë institucione të pavarura nga njëra tjetra. Po aq sa ç’është e pavarur prokuroria e posaçme nga Prokuroria e Përgjithshme, po kështu është edhe e anasjellta. Pra nuk kanë raporte ndërvarësie. Përveç kësaj e shkruar siç është në përkthimin në shqip, duket sikur ata janë të pazotë dhe të paaftë dhe kanë nevojë për asistencë. Pra, mendoj se duhet riformuluar në mënyrë të kujdesshme për t’i ndarë të dyja.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord me qëllimin dhe argumentin që dha zoti Smibert për këtë çështje. Në fund të fundit ata janë prokurorë dhe mund të kenë nevojë. Nuk mund ta caktojë ai, por duhet të jetë një çështje bashkëpunimi. Riformulojeni që ta qartësoni!

Jeni dakord?

Dakord në parim për të bërë një riformulim.

Jon Smibert - *(Flet anglisht)*

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Flet Përkthyesi) Jam dakord ta riformulojmë, por edhe mund ta heqim fare.

Fatmir Xhafaj – Duhet të jetë, por e riformuluar. Ata 10 veta janë dhe mund të gjenden nesër para situatave të vështira dhe mund të lindë nevoja për asistencë. Ta lëmë si hapësirë të mundshme, por duhet ta riformuloni.

Ulsi Manja – Duhet të bëhet lidhja me ligjin “Për prokurorinë!”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, riformulojeni!

Ramë dakord që nenin 29 ta shohë relatori së bashku me ekspertët për të bërë ndryshimin te pika 1 dhe riformulimin te pika 2.

Falënderoj të gjithë që morën pjesë në këtë diskutim!

Neni 30, “Detyrimet e autoriteteve të tjerë shtetërore”.

Ulsi Manja – Te pika 4 e këtij neni, aty ku flitet për sekretet shtetërore, propozoj të shtohet: “Aksesi i prokurorisë së posaçme dhe BKH-së në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave, duhet të jetë në përputhje me ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, të ndryshuar”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por mos e vini numrin e ligjit.

Jeni dakord?

Miratohet neni 30 me këtë ndryshim.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 31, “Detyrimet e Policisë së Shtetit”.

Jeni dakord?

Ulsi Manja – Ne jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Zoti Bylykbashi ka një amendament për këtë nen.

Oerd Bylykbashi – Ne sugjerojmë që për paragrafin 4 të këtij neni, gjithmonë në kuadër të ndarjes së qartë të BKH-së nga shërbimet e tjera të Policisë Gjyqësore që kanë organet e tjera, në mënyrë që të mos krijohet kjo varësi, sugjerojmë që paragrafi 4 të riformulohet, sipas asaj që kemi paraqitur me shkrim në amendamentin 8, që të mos ta lexoj.

Sigurisht, të gjitha shërbimet e tjera të Policisë Gjyqësore, janë të detyruara të bashkëpunojnë, për sa kohë BKH-ja e ka të nevojshme për t’i marrë, por kjo shkon në lidhje me atë që thamë. Pra, këta kanë strukturën e tyre të pavarur dhe për sa kohë kanë nevojë, të gjitha shërbimet e tjera, qoftë ato të Policisë së Shtetit, apo të doganave janë të detyruar të bashkëpunojnë dhe kjo është arsyeja që ne nuk shohim nevojën që të ngatërrohen të dyja.

Vexhi Muçmataj – Për nenin 31, te pika 1 për efekt të teknikës legjislative, ligji përdor fjali urdhërore, nuk vë kushte. Unë do të propozoja që të hiqet fjala “nëqoftëse” dhe kjo pikë të bëhet: “Çdo punonjës i Policisë së Shtetit që vjen në dijeni për kryerjen e një vepër penale...”

Edhe më poshtë te pika 4, kam diçka. Këtu thuhet: “Në bazë të kërkesës së një prokurori të posaçëm, ose në përputhje me urdhrat e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme...” Mendoj se këtu ka një diferencë: njëri bën kërkesë dhe tjetri jep urdhër. Ata të dy kanë të

njëtin funksion procedural për një çështje hetimore, prandaj mendoj se duhet të unifikohet shprehja, ose kërkesë ose urdhër, qoftë për drejtuesin, qoftë për prokurorët e posaçëm. Pra, të unifikohet shprehja te pika 4 e këtij neni. Ata të dy kanë funksion procedural në hetimin e një çështjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te pika 4 thuhet: “Në bazë të kërkesës së një prokurori të posaçëm, ose në përputhje me urdhrat e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme...”

Fatmir Xhafaj – Shiko djathtas se është hequr kjo!

Vexhi Muçmataj – Në rregull. Nuk e kam parë këtë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Hoxha!

Artan Hoxha - Unë them si teksti, ashtu edhe riformulimi që propozon zoti Bylykbashi, në fakt kanë më shumë funksion procedural, sesa raport institucional. Ne mendojmë se duhet riformuluar neni 4, më shumë sipas propozimit të zotit Bylykbashi, por duhet të kenë më shumë raport institucional sesa raport procedural.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ju falënderoj për mirëkuptimin!

Riformulohet paragrafi 4, duke mbajtur parasysh propozimin e zotit Muçmataj për efekt të teknikës legislative. Nuk mund të fillojë fjalia me: “nëqoftëse”.

Miratohet neni 31 kalojmë te neni 32.

Ulsi Manja – Ne jemi dakord me variantin e shkruar në draft.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Ne kemi një amendament, i cili e përfshin më mirë të gjithë gamën e veprimeve të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Ky amendament synon ta përmirësojë këtë nen. Si ta vlerësojë komisioni.

Petrit Vasili – Në rast se ekspertët ju japin tagrin që ta pasuron me ndonjë element edhe nga amendamentet e opozitës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Formulimi ynë është sipas amendamentin 9, që të mos ta lexoj të tërin.

Fatmir Xhafaj – Le ta shohin ekspertët!

E lëmë në dorë të ekspertëve.

Kalojmë te neni 33, “Byroja Kombëtare e Hetimit”.

Ka gjë për këtë nen?

Oerd Bylykbashi – Kemi ne një amendament për këtë nen. Gjykojmë që gjithmonë, në kuadër të asaj që BKH-ja edhe në fazën e organizimit, të funksionimit dhe të rekrutimit, duhet të jetë e pavarur nga Policia e Shtetit.

Fatmir Xhafaj – Kjo është thënë fjalinë, që kur është folur për prokurorinë e posaçme.

Oerd Bylykbashi – Kjo duhet të fillojë që në momentin që këta rekrutohen. Në këtë moment këta nuk mund të jenë, por edhe në mënyrë si funksionojnë dhe si organizohen. Gjithmonë në kuadër të kësaj, ne mendojmë që paragrafi 4, i nenit 33 të shfuqizohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë do ta bëjë ai.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ekspertët kanë bërë një riformulim. Bini dakord me riformulimin e bërë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Ulsi Manja – Pjesa me të kuqe, e zgjidh plotësisht shqetësimin e opozitës dhe vjen në përputhje me parashikimin kushtetues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po, me gjithë shtesën. Biem dakord me ndryshimin.

Vexhi Muçmataj – Kisha edhe diçka, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni.

Vexhi Muçmataj – BKH-ja është një seksion. Do të thosha që është një strukturë, sepse ajo përbëhet nga ...

Fatmir Xhafaj – Ke shumë të drejtë, thamë që ose do të lihet “seksion”, ose do të lihet “strukturë”. Ke shumë të drejtë.

Miratohet neni 33 me sugjerimin e bërë nga ekspertët dhe me propozimin për zëvendësimin e fjalës “seksion” me fjalën “strukturë” te pika 1.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Opozita votoi kundër.

Oerd Bylykbashi – Që të jetë e qartë: votojmë kundër, sepse ju përfshini këtu edhe Policinë e Shtetit. Ne gjykojmë që duhet të jetë pjesë integrale e BKH-së.

Fatmir Xhafaj – Janë të dyja.

Oerd Bylykbashi – Jo, nuk janë. Formulimi që keni bërë ju, e krijon këtë.

Fatmir Xhafaj – Nuk e kemi bërë ne, e kanë ata.

Neni 34, “Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Keni gjë për nenin 34?

Vexhi Muçmataj – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Ju jeni dakord dhe as opozita nuk ka paraqitur ndonjë propozim për nenin 34.

Miratohet neni 34.

Faleminderit!

Neni 35, “Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit”.

Vexhi Muçmataj – Jo, jemi dakord me nenin 35.

Fatmir Xhafaj – Ju nuk keni gjë. As opozita nuk ka paraqitur ndonjë propozim për nenin 35.

Miratohet neni 35.

Faleminderit!

Neni 36.

Keni gjë për nenin 36?

Vexhi Muçmataj – Jo, jemi dakord.

Oerd Bylykbashi – Kemi një amendament, për këtë nen, i cili është amendamenti nr. 11, që synon të rregullojë kriteret e emërimit të drejtorit të njësisë së posaçme hetimore në mënyrë të tillë, që të jetë i hapur. Konkurrimi nuk mund të jetë i mbyllur vetëm për ata funksionarë, të cilët janë sot në detyrë. Duhet të jetë i hapur për ata, që plotësojnë kushtet që parashikon ligji.

E dyta, kemi bërë propozimin për futjen e kriterëve shtesë në lidhje me këtë funksion. Kriteret për personat, të cilët kanë qenë në gjyqe politike në kohën e regjimit komunist, në shërbimet sekrete të kohës, apo edhe kufizimin, të cilin e kemi aplikuar edhe në

raste të tjera, në lidhje me ekspertët që janë përfshirë në procesin e reformës në drejtësi. Pra, janë një seri kriteresh, të cilat synojnë që kjo garë të jetë e hapur dhe e rregulluar më mirë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Artan Hoxha – Për ta kuptuar, në paragrafin e parë të propozuar nga ekspertët, është kufizuar fusha apo rrethi i personave nga vijnë. Propozimi juaj, zoti Bylykbashi, është që të jetë e lirë?

Oerd Bylykbashi – Unë jam dakord me riformulimin që është bërë nga ekspertët, që është në krahun e djathtë.

Artan Hoxha – A duhet të jetë i kufizuar apo të jetë më e lirë?

Oerd Bylykbashi – Pra, riformulimi me të kuqe, që është këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është riformulimi ynë.

Artan Hoxha - Po flet për amendamentin nr. 11?

Oerd Bylykbashi – Po, për amendamentin nr. 11, të cilin kemi propozuar ne. Këtu ka një riformulim nga ekspertët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të doja një koment nga zoti Smibert, pavarësisht se mund të jetë njësoj me propozimin tonë, çështja është nëse pranohet ky propozim, i cili ka ardhur këtu, sepse nuk janë të gjitha amendamentet tona, të përfshira në këtë dokument, por janë propozime që vijnë nga ekspertët. Nëse ky propozim qëndron, ne do të ishim dakord.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Smibert!

Ju lutem zoti Hoxha, qartësojeni se për çfarë bëhet fjalë!

A e keni tabelën me dyja ndarjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pretendimi i zotit Bylykbashi është që nenin 36 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, amendamenti i PD-së, pa asnjë ndërhyrje.

Urdhëroni zoti Smibert, për një koment!

Jon Smibert - *(Flet anglisht)*

(Flet përkthyesi) – Te neni 36 kemi marrë parasysh në një masë të madhe propozimin e PD-së. Gjithsesi, po vija re tani, se paragrafi 1 e hap gamën apo listën e personave, kurse paragrafi i dytë, pika “c”, duket sikur e kufizon përsëri te radhët e Policisë së Shtetit.

Jon Smibert - *(Flet anglisht)*

(Flet përkthyesi) – Pra, tek e para e linte të hapur, kurse te paragrafi i dytë, pika “c” duket sikur e kufizon përsëri te radhët e Policisë së Shtetit.

Korajlka Bumci - *(Flet anglisht)*

(Flet përkthyesi) – Pra, te pika “d” ku thuhet që nuk ka një përvojë 10-vjeçare, si prokuror, për mendimin tim, është tepër e gjatë si periudhë. Ju sugjeroj ta heqim këtë kriter, sepse për mendimin tim, është tepër e gjatë si periudhë.

Gjithashtu, nuk e kuptoj pse duhet ta mbajmë paragrafin e tretë, pra periudhën përjashtimore prej 20 vjetësh. Sugjeroj ta heqim edhe paragrafin e tretë.

Të paktën në versionin anglisht, nuk qëndron. Nuk e di nëse në versionin shqip është e njëjta gjë, apo jo.

Mendoj që nuk ka nevojë përjashtimisht për një periudhë 5- vjeçare. Mendoj se nuk ka nevojë për një periudhë kaq të gjatë.

Mendoj që kjo pikë qëndron te ligjin për vetingun, por jo këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi – Pjesa që është në krahun e djathtë nuk është amendamenti ynë. Ai është propozim që vjen nga ekspertët.

Për sa i përket pikës së fundit, unë besoj që është çështje e një mençurie politike, pra është një vendimmarrje e një natyre tjetër. Siç vlen për vetingun, i njëjti diskutim bëhet edhe për këtu për një periudhë tranzitore. Nëse do të ketë ekspertë të nivelit të lartë që do të donin ta merrnin atë detyrë apo jo, pra do ta konsideronin të vlefshme, kjo është çështje tjetër. Kjo detyrë është e rëndësishme, për sa kohë ka qenë një diskutim i qartë, me karakter politik.

E dyta, për sa kohë është pranuar në një organ tjetër, siç është ai i vetingut, ne gjujkojmë se është e rëndësishme të jetë aty. Pra, personat, të cilët kanë krijuar këto poste pune, nuk përfitojmë nga ato poste pune për një periudhë tranzitore.

Për sa i përket elementeve të tjera, gjykojmë që ju keni hequr paragrafin “b”, te pika 1, ku shqetësimi kryesor ishte ndoshta, kufizimi i madh që shkakton afati 10-vjeçar. Kjo do të krijonte ndoshta një situatë, e cila do të limitonte kapacitetet disponibël për të kryer këtë detyrë.

Nga ana tjetër, heqja e kësaj do ta çonte te limitimi që krijohet nëpërmjet leximit të germës “ç”, ku duket sikur këta vijnë vetëm nga Policia e Shtetit. Për rrjedhojë, nëse heqim te germa “b” vetëm kufizimin 10-vjeçar, por e lëmë pjesën tjetër, që do të na jepte grupin e profesionistëve, që do të vinin nga Policia e Shtetit, Policia Gjyqësore, apo hetuesit e njësisë së posaçme hetimore apo edhe prokurorët, duke hequr paragrafin 10, e zgjerojmë gamën dhe nuk na krijohet kjo përplasje. Gjykojmë që për pjesën tjetër, siç keni rënë edhe ju dakord, me këtë që keni propozuar këtu, unë besoj se e zgjidhim, duke hapur gamën edhe si profile edhe si moshë, duke hequr kufizimin 10-vjeçar.

Fatmir Xhafaj – Çfarë është kufizimi 10-vjeçar?

Oerd Bylykbashi – Te germa “b” është kufizimi 10-vjeçar: jo më pak se 10 vjet si prokuror etj...

Kjo do të thotë që mund të ketë pak njerëz në dispozicion me moshën e përshtatshme, me kapacitetet e përshtatshme etj.

Unë bie dakord që kufizimi 10-vjeçar të bjerë dhe të thuhet: “Ka eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit, apo i Policisë Gjyqësore ose të jetë një hetues i njësisë së posaçme hetimore.” Këto janë 4 profilet nga mund të vijnë këta figura, pa kufizimin 10-vjeçar.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Në fakt shqetësimi që ngre zoti Bylykbashi, është i zgjidhur te varianti origjinal i ligjit që ne kemi përpara. Reformulimi që keni sjellë ju, e mbyll procesin. Pse?

Në variantin e diskutuar dhe dakordësuar me ekspertët më datë 8 shtator 2016, thuhet: “Drejtori mund të vijë nga radhët e Policisë së Shtetit, apo të Policisë Gjyqësore, një hetues i BKH-së apo nga radhët e prokurorëve”.

Ju me riformulimin që keni bërë, keni hequr mundësinë që të vijë nga radhët e prokurorëve. Shqetësimi që keni ju, që rrethi i personave duhet të jetë shumë i gjerë, mendoj se e zgjidh shprehja e përdorur: mund të vijnë nga radhët e hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pse? Sepse në nenet 39 dhe 40 të ligjit, lidhur me kriteret se kush mund të jetë hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, parashikohet se hetuesi duhet të jetë shtetas shqiptar; të ketë arsimin e lartë policor, arsim të lartë në drejtësi, kontaliblist dhe arsim të lartë në degë të tjera që lidhen me të. Kjo është shumë më e gjerë se merakun që shpreh zoti Bylykbashi. Pra, neni 36, paragrafi 1, duhet parë sipas përkufizimit që kanë sjellë ekspertët me nenin 40 të ligjit.

Së dyti, unë jam shumë dakord që ekspertët kanë fshirë kufizimin “10 vjet”, sepse është shumë.

Së treti, unë kam një shqetësim tjetër: në propozimin që ka sjellë opozita thuhet “personi të mos jetë nën hetim ose në gjykim për një veprë penale dhe të mos ndodhet në kushtet e pazgjydhshmërisë në një funksion publik sipas ligjit 138 të vitit 2015”. Unë jam dakord që duhet të ketë kriteret të forta, por kriteri që ka vënë opozita është i butë. Unë mendoj se drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të jetë 100% i pastër. Pra, jo vetëm të mos jetë në gjykim në momentin kur ai kandidon, por nuk duhet të ketë kryer vepra penale edhe më parë; jo vetëm nuk duhet të ketë kryer veprat penale që parashikohen në ligjin 138, sepse aty ne kemi një listë veprash të rrezikshme, por ky person duhet të jetë shumë i pastër. Po flasim për një person që do të jetë drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Gjithashtu, kolegë, opozita ka shtuar një variant. Në ligjin që kanë sjellë ekspertët kanë thënë se drejtori duhet të jetë vetëm me shtetësi shqiptare, kurse ju keni pranuar që mund të ketë edhe shtetësi tjetër. Unë sugjeroj që drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të ketë vetëm shtetësi shqiptare. Ju e keni hequr ...

Fatmir Xhafaj - E keni te pika 2: “Kandidati për drejtor mund të jetë çdo shtetas shqiptar”.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, në variantin që kanë sjellë ekspertët kanë thënë se duhet të ketë vetëm shtetësi shqiptare.

Fatmir Xhafaj - Po është këtu: “Kandidati mund të jetë çdo shtetas shqiptar”.

Vasilika Hysi - Po sikur të ketë dy shtetësi? Po flasim për ata kandidatë që kanë dy shtetësi. Po nëse kandidati mund të ketë shtetësi arabe ose turke dhe shtetësi shqiptare, a do ta vendosni drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Është diskriminim pozitiv dhe jam dakord me zonjën.

Vasilika Hysi - Ju lutem, këtu po flasim për drejtorin, nuk po flasim për hetuesin, sepse për hetuesin nuk janë vënë kritere.

Oerd Bylykbashi - Nuk ka asnjë lloj diference, sepse t'i heqësh të drejtën për të kandiduar një shtetasi shqiptar vetëm se ka një shtetësi tjetër, kjo nuk mund të ndodhë. Për sa kohë kjo është e ligjshme, pra që të ketë edhe shtetësi tjetër, një shtetas shqiptar që ka edhe shtetësi kanadeze, mund të vihet drejtor.

Vasilika Hysi - Zoti Bylykbashi, ky është mendimi im, ja ku i kemi ekspertët dhe le të shprehen.

Oerd Bylykbashi - Do t'i shtojmë ligjit pastaj çështje antikushtetueshmërie dhe do të bëjmë gabime. Ne jemi gati ta shkruajmë paragrafin për antikushtetueshmërinë, kështu që të mos e ngatërrojmë punën.

Vasilika Hysi - A mund ta përfundoj fjalën? Vetëm në Shqipëri ndodh që në shërbimet më të specializuara janë njerëzit me dy shtetësi, që raportojnë edhe në shtetin ku kanë shtetësinë, edhe tek autoritetet tona. Provo të jesh në Gjermani, megjithatë i kemi ekspertët këtu dhe mund të na e thonë.

Unë kam edhe një shqetësimi tjetër, zoti kryetar, lidhur me germën “d”. Këtu thuhet se këta punonjës nuk duhet të kenë pasur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në ndonjë parti të paktën për 10 vjetët e fundit. Unë lexova Kushtetutën dhe përkufizimet për përkatësi politike janë për gjyqtarët, janë për prokurorët, për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kurse hetuesit janë për 10 vjet. A e kuptoni se çfarë kufizimesh po vëmë?

Oerd Bylykbashi - Nuk e di se ku e lexoi zonja Hysi që ne heqim prokurorët?! Lexo germën “b”, mos lexo atë që është aty, se ajo që është shtuar këtu te krahu i djathtë dhe nuk e përfshin germën “b”, që ka neni i propozuar nga ne. Në versionin që është sjellë sot nga ekspertë ndërkombëtarë në germën “b” thuhet: “Ka eksperiencë pune jo më pak se 10 vjet si

prokuror; si punonjës i Policisë së Shtetit; si punonjës i Policisë Gjyqësore ose si hetues Njësisë së Posaçme Hetimore”. Tani ajo që po themi ne është se duhet hiqet shprehja “jo më pak se 10 vjet” dhe të thuhet: “Ka eksperiencë pune si prokuror...” dhe vazhdon. Pra, këtu ne kemi përfshirë edhe prokurorët dhe nuk e di se ku e lexuat ju ndryshe.

Së dyti, formulimi, siç e keni sjellë ju sot, e kufizon vetëm “oficerë dhe përgjegjësia në detyrë”.

Fatmir Xhafaj – A mundet t’i lemë këto tani? Unë jam dakord.

Ju lutem, mos e zgjasni kot, por ta mbyllim diskutimin dhe lihet: “Ka eksperiencë si prokuror, si punonjës i Policisë së Shtetit...” e të tjerë.

Vasilika Hysi - Edhe unë, zoti kryetar, për këtë jam, por të vihet të paktën 5 vjet për çështjet që kanë të bëjnë me veprat penale në kushtet e korrupsionit; krimin të organizuar dhe krimeve të rënda. Ai mund të këtë punuar në një agjenci, për shembull, në Kombet e Bashkuara, mund të këtë punuar në një agjenci në Bruksel, në rast se ai ka përvojë në fushën e hetimit lidhur me krimin e organizuar, në fushën e krimeve të rënda, në fushën e korrupsionit, nuk duhet ta kufizojmë, që të vijë dhe të punojë këtu, sepse kështu do të humbasim asetet që ne kemi. Prandaj, këtë gjë po i them edhe Oerdit që ta ruajmë.

Fatmir Xhafaj - Në rregull. A kemi diçka tjetër lidhur me këtë?

Oerd Bylykbashi - Cili version po pranohet?

Fatmir Xhafaj - Do të pranohen të gjitha ndryshimet që u bënë këtu lidhur me shtetësinë shqiptare dhe do të heqim variantin e 10-vjeçarit, si edhe pikën 3.

Oerd Bylykbashi - Pika 3 është një nga çështjet që ne kemi qenë gjithmonë në diskutim, madje është edhe në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj - Jo nuk e kemi në Kushtetutë.

Oerd Bylykbashi - Atëherë, ne mund të krijojmë poste sa të duam për veten tonë dhe mund ta shkruajmë këtu. Kështu le t’i heqim kufizimet e tjera, se mund të shkojmë edhe vetë pasi të ikim nga mandati deputetit. Ky është i gjithë diskutimi. Atëherë, për sa i përket paragrafit 3, ne kërkojmë që të qëndrojë kështu siç është.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ne votojmë kundër, kështu që nuk kalon.

E hedhim në votë nenin 36, me ndryshimet e propozuara, pa pikën 3.

Në rregull!

Vazhdojmë me nenin 37 “Lirimi, shkarkimi ose pezullimi nga detyra e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”?

Ulsi Manja - Jemi dakord me nenin 37.

Fatmir Xhafaj - Neni 38?

Ulsi Manja - Jemi dakord edhe me nenin 38.

Fatmir Xhafaj - Neni 39 “Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit”?

Ulsi Manja – Neni 39 është shtuar me paragrafin 3 të marrë nga neni 40 i këtij ligji.

Fatmir Xhafaj - A ka diçka për të shtuar? Në rregull.

Vazhdojmë me nenin 40?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 41 “Shërbimet e Policisë Gjyqësore”?

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Atëherë, ne nuk pranojmë që oficerët e përzgjedhur, në formulimin e paragrafit 2, të caktohen nga institucionet e tyre përkatëse. Ky është një proces, që edhe në paragrafin 3 flet për një proces aplikimi të hapur. Nga ana tjetër, në paragrafin 1 thuhet: “Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërjen e saj shërbimet e Policisë Gjyqësore”, pra është pjesë përbërëse e saj. Se ç’kanë institucionet e tjera shërbime të ngjashme, kjo është çështje e tyre. Në këtë aspekt këta nuk caktohen nga institucionet e tyre, por është SPAKU që e mbyll këtë.

Së dyti, unë mendoj se formulimi nuk duhet të jetë për një mandat deri në 5 vjet, por duhet të jetë 5 vjet, sepse jep një lloj garancie më të madhe, edhe në kuadër të asaj, që më pas janë të pavarur prej institucionit të tyre. Për sa kohë ata janë persona, të cilët caktohen sipas propozimit nga institucionet e treta, pavarësia nuk është reale. Gjithashtu, ne nuk pranojmë që Policia e Shtetit të organizojë një proces aplikimi për këtë gjë. Ky duhet të jetë një proces, që do të zhvillohet në mënyrë ekskluzive nga vetë struktura, pra nga SPAKU. Aq më pak, ne shohim nevojën që për të krijuar këto struktura që janë në përbërje të Byrosë Kombëtare të Hetimit të jetë drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, që të nxjerrë rregulla të përbashkëta me drejtorin e Byrosë Kombëtare të hetimit, vetëm nga Byroja Kombëtare e Hetimi. Kjo krijon varësi dyfish, aq më tepër në qoftë e kemi deri në 5 vjet, për një periudhë

6-mujore apo 1-vjeçare ky person, i cili emërohet dhe shkarkohet nga eprori i tij në institucionin e tretë nuk mund të jetë i pavarur. Ky formulim është deklarativ, kështu siç është, për sa kohë nuk bëhen ndryshime, pra të hiqet roli që ka Policia e Shtetit qoftë në rekrutimin, qoftë në nxjerrjen e rregullave për punësim, qoftë edhe në organizmin e brendshëm.

Fatmir Xhafaj - Ekspertët ndërkombëtarë kanë bërë një ndryshim te neni 41, kanë ndryshuar pikën 2: “Ata janë të pavarur nga institucionet e tyre dhe vendosen në varësinë procedurale, hetimore të kreut të Prokurorisë së Posaçme”. Pra, e kanë shprehur në mënyrë të qartë pavarësinë.

Oerd Bylykbashi - Ajo që ne po themi është që këto formulime...

Fatmir Xhafaj – Ju e doni siç e keni ju?

Oerd Bylykbashi - Pavarësisht se çfarë kanë shkuar në këtë rast ekspertët ndërkombëtarë, ajo që ne të gjithë e dimë është se një person, i cili pas 6 muajsh, pas 1 viti apo pas 2 vjetësh kërkon të rikthehet atje ku ka qenë më parë, tek ai që i emëron dhe i shkarkon, këta persona nuk janë më të pavarur.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Jo, kjo pjesë nuk është fare. Unë po them se ai njeri është në ndikim të eprorit të institucionit tjetër.

Ta nisim nga koka, paragrafi 1 flet për Byronë Kombëtare të Hetimit, që ka në përbërjen e saj Shërbimin e Policisë Gjyqësore. Policia e Shtetit, doganat e të tjerët janë institucione të tjera, kurse ne po flasim për strukturën e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Nëse dikush tjetër ka kompetenca mbi funksionarët që janë në shërbim, janë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit, nuk ka pavarësi.

Fatmir Xhafaj - Zoti Smibert ka kërkuar fjalën.

John Smibert – *(flet përkthyesi)* Faleminderit!

Sot në mëngjes ne patëm rastin ta bisedonim hartimin e nenit 41 edhe me përfaqësuesit e opozitës, por, gjithashtu, edhe me zonjën ramë dakord, deri diku, dhe e shtuam pak fjalorin. Mënyra si ramë dakord për ta formuluar këtë nen m'u duk se ishte e pranueshme.

Fatmir Xhafaj - Nuk jeni kuptuar?

Oerd Bylykbashi - Nuk ishte kjo ajo për të cilën kemi rënë dakord.

Ne kemi kërkuar një ndarje të qartë dhe të pastër. Kjo është strukturë e Byrosë Kombëtare të Hetimit, janë persona, të cilët konkurrojnë në mënyrë të lirë, të hapur, shërbejnë atje në gjykimin tonë për 5 vjet, jo “deri në 5 vjet” dhe këta persona nuk kanë varësi nga personat e tretë. Nëse Byroja Kombëtare e Hetimit do të bashkëpunojë me shërbimet e tjera të Policisë Gjyqësore, kjo është çështje tjetër, por këta duhet të jenë krejt të pavarur, në kuadër të strukturës së Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Problemi që u ngrit, se çfarë do të bëhet me këta persona pasi të mbarojnë detyrën, këtë duhet ta rregullojë ligji, sepse ligji duhet të garantojë që në përfundim të ushtrimit të kësaj detyre, sipas afatit që do të përcaktohet, këta persona do të kthehen në detyrat që kishin në Policinë e Shtetit apo në organet e tjera nga vijnë. E njëjta gjë që ndodh me prokurorët apo gjyqtarët që largohen nga struktura përkatëse dhe ushtojnë funksione të tjera, në organe të tjera, që janë të garantuar se në përfundim të kësaj detyre do të kthehen atje ku kanë qenë më parë. Ne duhet të garantojmë, në çdo rast, pavarësinë e këtij institucioni dhe jo eksesin, përfshirë me rekrutim nga Policia e Shtetit, sepse këta që do të rekrutohen nga Policia e Shtetit sigurisht që do t'i përgjigjen atij që i ka rekrutuar dhe jo atij që i jep rrogën.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Kemi dy qëndrime, dhe ju e keni debatuar këtë gjë në mëngjes. Ekspertët kanë sjellë një formulim. A biem dakord me formulimin e ekspertëve për nenin 41?

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, unë e kuptoj vendosmërinë tuaj dhe është qartazi tentativë për ta kapur nga brenda këtë histori, por pranojeni që nuk hiqni dot dorë nga kjo pjesë.

Vexhi Mucmataj - Kam një sugjerim të vogël për rregullimin e pikës 2, rreshti 5, ku thuhet: “Raportojnë te zëvendës drejtori dhe vlerësohen nga zëvendës drejtori”. Unë mendoj se kjo pjesë duhet hequr dhe fjala “në përfundim të këtij mandati zëvendës drejtori bën vlerësimet”, sepse vlerësimin e bën drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Në diskutimin që kishim sot me ekspertët, me zotin Smibert dhe me zonjën Bumçi, menduam se kjo që po shohim këtu është e pranueshme, por unë dua të di

edhe një herë: ju mendoni ta reflektoni në këtë formë siç ka ardhur këtu, jo ajo që ne propozuam gjatë diskutimit, se kjo është shumë ndryshme?

John Smibert – *(flet përkthyesi)* Në paragrafin 3 fjalia e parë do të hiqet.

Fjalja e dytë në paragrafin 3 do të qëndrojë, kurse pjesa që vjen pas fjalisë së dytë, në paragrafin e tretë dhe në paragrafin e katërt, do të ndryshojë si më poshtë: “Byroja Kombëtare e Hetimit do të kryejë një proces të hapur dhe transparent aplikimi, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, nga punonjësit e kualifikuar të drejtorive të Policisë së Shtetit përgjegjës, për hetimet e krimit të organizuar, krimit ekonomik, trafikimit të lëndëve narkotike, seksioneve të tjera përkatëse dhe nga institucionet e tjera përkatëse me funksionet e Policisë Gjyqësore. Në fund të periudhës 5-vjeçare, të emërimit të përkohshëm, këta punonjës do të kthehen në institucionet nga kanë ardhur në pozicione të njëjta ose më të larta”.

Fatmir Xhafaj - A jeni dakord?

Oerd Bylykbashi - Formulimi që tha “në fund të periudhës 5-vjeçare” kërkon që të jetë edhe kjo 5 vjet, jo deri në 5 vjet.

Fatmir Xhafaj - Por ai mund ta marrë edhe 2 vjet, se aq nevojë ka.

Oerd Bylykbashi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Në rregull me riformulimin e nenit 41?

(Diskutime pa mikrofon.)

Neni 42 “Statusi i Policisë Gjyqësore”?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 43 “Largimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit”.
Dakord?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 44 “Oficeri përgjegjës për mbikëqyrjen”?

Oerd Bylykbashi - Ne gjykojmë se pavarësia duhet të jetë e qartë në lidhje me këtë proces që kryhet me kontrollin e brendshëm. Në fund të diskutimit që bëmë me ekspertët sot u sugjerua që mund të futet një formulim, pra duke lënë oficerët...

Fatmir Xhafaj - Më fal, ju keni thënë që ky amendament të shfuqizohet? Ata kanë sjellë një formulim, kurse ju keni bërë një amendament, që neni 44 të shfuqizohet. Këtë e keni shkruar ju, jo ne.

(Diskutime pa mikrofon.)

Oerd Bylykbashi - Atëherë, ne kishim propozuar një koncept tjetër, pra të shfuqizohej neni 41 për shkak se kjo detyrë, sipas sugjerimit tonë, duhej t'i kalohej prokurorit. Në diskutimin që bëmë sot me ekspertët, duke lënë oficerët përgjegjës, të cilët do të bëjnë monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve financiare apo edhe të telekomunikimeve, sugjeruam dhe ramë dakord në gjuhë që të jetë e qartë që një prokuror i Prokurorisë së Posaçme do të drejtojë dhe do të kontrollojë punën që do të kryejnë oficerët përgjegjës. Pra, nuk është thjesht një prokuror i gatshëm, i cili merr të dhënat kur gjykon, por ai drejton dhe kontrollon punën që do të kryejnë oficerët përgjegjës. Në mënyrë që kjo gjë të mos jetë e shkëputur nga Prokuroria e Posaçme, duhet të jetë një prokuror, i cili të kontrollojë të gjithë procedimin që do të kryhet.

Vasilika Hysi – Propozimi që bën kolegu Bylykbashi bie ndesh me Kushtetutën. Në Kushtetutë, në nenin 148, paragrafi 4, i ndryshuar nga neni 32, theksohet se prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe stafet janë të pavarur nga prokurori i Përgjithshëm. Çfarë bëjnë kolegët e opozitës? I japin të drejtë prokurorit të Përgjithshëm që çdo 6 muaj të organizojë me short dhe të zgjedhë.

Oerd Bylykbashi - Ne kemi hequr dorë nga kjo Vasilika.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Atëherë, mund të mbaroj unë, sepse sa herë që filloj të flas ju ndërhyini.

Riformulimi që kanë sjellë ekspertët lidhur me nenin 44 e zgjidh merakun që kanë kolegët e opozitës në raport me drejtorin e Përgjithshëm dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Roli që do të ketë oficeri përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit është se do të kontrollojë, në mënyrë periodike, punën e kryer nga drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave. Ajo që ne duhet të diskutojmë tani nuk është amendimi i kolegëve të opozitës, se ata e kanë dhënë që ta shfuqizojnë këtë nen, por

ndërmjet draftit paraprak që kanë paraqitur në shtator kolegët me ndryshimet që na kanë ardhur sot në mëngjes dhe që janë me ngjyrë të kuqe.

Ulsi Manja - A mundem kryetar?

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Propozimi që sjellin ekspertët për nenin 44 lidhur me oficerin përgjegjës për mbikëqyrjen, mua më duket se pika 5 e zgjidh këtë shqetësim. Pra, ky oficer mbikëqyrjeje do të raportojë te një prokuror i Posaçëm, jo te prokurori i Përgjithshëm, i cili do të zgjidhet me short. Pra, brendapërbrenda Prokurorisë së Posaçme oficeri mbikëqyrës do të kontrollohet nga një prokuror i gatshëm i posaçëm dhe këto gjëra i sjellin ekspertët në riformulimin që i kanë bërë nenit 44.

Oerd Bylykbashi – Edhe ne e duam këtë gjë që thatë ju, zoti Manja, që prokurori i Posaçëm i zgjedhur me short ta kontrollojë këtë punë, por nuk janë aty. Kështu që unë dua të di edhe opinionin e ekspertëve lidhur me këtë diskutim që po bëjmë, pra futjen e një teksti, i cili do t'i jepte prokurorit të caktuar me short kompetencën për të drejtuar dhe kontrolluar punën që do të bëjnë këto struktura.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

A keni ndonjë koment tjetër mbi komentin që keni bërë vetë?

Jon Smibert – *(flet përkthyesi)* Ne e diskutuam edhe në mëngjes që oficeri përgjegjës nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave do të kontrollohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme. Ne jemi dakord me paragrafin 5 ashtu siç është shkruar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Zotëri, ja ku është e shprehur: “Oficeri përgjegjës raporton çdo informacion që ngre dyshime të arsyeshme për veprime korruptive te prokuroi i Posaçëm i gatshëm”.

Oerd Bylykbashi - Mund të ndodhë që ky oficeri të vendosë që të mos raportojë këtë gjë. Ne po ia japim drejtimin dhe kontrollin e kësaj gjëje direkt prokurorit. Pra, ekspertët nuk janë kundër që të shtohet ky togfjalësh ose një fjali menjëherë pas fjalisë së parë, e cila do të rregullonte drejtimin dhe kontrollin.

Fatmir Xhafaj - A e votojmë dhe e risistemojmë nëse ka ndonjë gjë? Dakord, miratohet neni 44.

Neni 45 “Marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me strukturat e tjera policore”? Dakord.

Neni 46?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Te titulli që keni vënë ju këtu: “Organeve të specializuara të strukturës së posaçme kundër korrupsionit” keni parasysh prokurorinë dhe BKH-në, apo jo? Në rregull.

Neni 47?

Ulsi Manja - Dakord me nenin 47.

Fatmir Xhafaj - Ka këtu një paragraf, ku thuhet: “Punonjësit kanë detyrimin e vazhdueshëm të përditësojnë deklaratat sipas nevojë dhe të deklarojnë çdo konflikt interesi te kancelari, te gjyqtari apo te prokurori përkatës”. Tani “te kancelari dhe te gjyqtari” dhe “te kancelari dhe te prokurori” është e pakuptimtë sepse brenda një institucioni i bie ta deklarojnë dy herë, kështu që duhet ta qartësoni këtë gjë.

Jeni dakord me nenin 47? Ju lutem, bëjeni ndarjen se ku do ta bëjë përditësimin.

Miratohet neni 47, me ndryshimet e bëra.

Neni 48 “Siguria e mjediseve”?

Ulsi Manja - Dakord me nenin 48.

Fatmir Xhafaj - Neni 48 “Shërbimet e sigurisë së shtetit kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin dhe mbikëqyrjen”. Nuk mendoj se këtu duhet fjala “nën drejtimin” se kryetari i gjykatës nuk do të drejtojë shërbimet e sigurisë, por duhet “nën mbikëqyrjen” se ata i drejton Policia e Shtetit.

Jemi dakord me nenin 48?

Ulsi Manja – Po, dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 49 “Siguria e personelit”?

Ulsi Manja - Jemi dakord edhe me nenin 49.

Fatmir Xhafaj – Neni 50 “Heqja dorë”?

Ulsi Manja - Dakord me nenin 50.

Oerd Bylykbashi - Te neni 50 ne kemi bërë një amendament nr. 14, por propozimi i parë për ndryshimin e paragrafit e fjalisë së fundit...

Fatmir Xhafaj – Në nenin 50 bëhen dy ndryshime te fjalia e fundit e paragrafit 3.

Oerd Bylykbashi - Riformulimi që diskutuam në nenin 44 besoj se e zgjidh këtë çështje, pasi është në funksion të saj. Ndërkohë, te paragrafi 4 ne propozojmë një riformulim, sepse gjykojmë se kjo deklaratë nuk është vetëm për oficerin përgjegjës të drejtorisë, por edhe për oficerin mbikëqyrjes.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Dakord, të ndryshohet.

Fatmir Xhafaj - Bëjeni në dy kopje se e ka me merak të madh.

Ulsi Manja - Të hiqet fjala “oficeri përgjegjës i BKH-së” dhe të ndryshohet me “prokurori përgjegjës”.

Oerd Bylykbashi - Mund të jetë edhe te njëra, edhe te tjetra.

(Diskutime pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, kolegu Bylykbashi sugjeroi se gjyqtarët duhet ta dorëzojnë deklaratën edhe tek oficeri përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, edhe tek ai i BKH-së, po, më falni, te gjyqtari i BKH-së? Në draftin që kanë sjellë ekspertët është e parashikuar shumë mirë: “Deklarata dorëzohet tek oficeri përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave” dhe e kemi vënë në një nen sipas ekspertëve, që një oficer përgjegjës i BKH-së monitoron vëzhgimin periodik që bën oficeri përgjegjës i Departamentit të Pastrimit të Parave. Përderisa ky do të kontrollojë sistematikisht të gjitha vëzhgimet periodike të këtij...

Oerd Bylykbashi – Po kush do ta monitorojë këtë gjë?

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë Oerd, se nuk ta kanë qartësuar këtë gjë: prokurori është i përkohshëm, kurse oficeri është i përhershëm.

(Diskutime pa mikrofon.)

A e doni me dy kopje? Në rregull.

Faleminderit, neni 50 të bëhet “në dy kopje”.

Neni 51 “Deklarimi dhe kontrolli fillestar”?

Ulsi Manja - Jemi dakord sipas variantit të draftit.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ne kemi bërë një amendament, i cili bashkon nenin 51 dhe nenin 52, duke qenë se janë në të njëjtat kushte, prandaj shfuqizohet edhe neni 52. Kjo është e nevojshme për t’u bërë në kuadër të riformulimit të nenit 6, që ne e kemi lënë të hapur. Pra, është i lidhur me atë nen, por i kemi bërë bashkë këtu për shkak se kanë të njëjtat kushte.

Fatmir Xhafaj - Po mirë, ne i kalojmë si nene të veçanta 51 dhe 52. Po pati efekte nga ndryshimi i nenit 6, le të reflektohen këtu.

Dakord.

Oerd Bylykbashi – Këtu shfuqizohet neni 52, sepse bëhen bashkë.

Fatmir Xhafaj – Neni 53 “Kontrolli periodik”?

Ulsi Manja - Dakord.

Vasilika Hysi - A do të biem dakord me amendamentet e tyre?

Ulsi Manja - Nuk ka amendime.

Vasilika Hysi – Po ka PD-ja.

Ulsi Manja - Dakord me draftin tonë, pra me nenin 53 te drafti.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Te neni 54 është bërë një shtesë: “Oficeri përgjegjës mbikëqyret nga

Dakord me nenin 54, sipas korigjimit që kanë bërë ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Neni 55 “Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga BKH-ja”?

Ulsi Manja - Jemi dakord me nenin 55, sipas variantit të paraqitur në draft.

Fatmir Xhafaj - Hiqni disa fjalë që janë këtu lidhur me indiciet e mëposhtme e të tjera. Zoti Hoxha, këtu disa fjalë, të cilat duhen përkthyer nga anglishtja në shqip.

Dakord me nenin 55.

Faleminderit!

Neni 56 “Mbrojtja e të dhënave”?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Moza, këtu do të hiqni vetëm numrin e ligjit.

Neni 57 “Raportimi i informacionit dhe provave”?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Jeni dakord me versionin e propozuar nga ekspertët, apo jo?

Fatmir Xhafaj - Ku?

Oerd Bylykbashi - Te neni 57.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Neni 58? Dakord.

Neni 59?

Ulsi Manja - Neni 59 “Buxheti”? Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 60?

Ulsi Manja - Lidhur me “Dispozitën kalimtare” ekspertët kanë bërë një shtesë.

Oerd Bylykbashi - Ne jemi dakord me propozimin e ekspertëve.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – A keni gjë tjetër për të shtuar për nenin 60 “Dispozita kalimtare”?

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë gjë për nenin 60?

Ulsi Manja -Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 61? Dakord.

Në rregull përfunduar. Kemi lënë të hapur nenin 6, për t’u reflektuar nëse do të ndryshojë.

Të gjitha nenet e tjera i kemi kaluar. Besoj se nenet janë mbajtur shënim dhe janë të qarta, duhet të bëhen vetëm disa shënime redaktoriale para votimit final. Po të shtojcat ka vërejtje? Nuk ka. Ka gjë tjetër? Nuk ka.

Ulsi Manja - Votimin në tërësi do ta bëjmë nesër apo sot?

Fatmir Xhafaj – Votimin në tërësi do ta bëjmë pasi të përfundojmë edhe nenin 6 me reflektimet.

Nesër në orën 10:00 do të diskutojmë projektligjin “Për prokurorinë në Republikën e Shqipërisë”.

Ju falënderoj për kontributin! Falënderoj zotin Smibert, zonjën Bumçi, zotërinjtë e OPDAT-it, përkthyesit dhe gjithë të tjerët!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

